

# 9 NËNTË SHENJA



*të një*

# KISHE TË SHËNDETSHME

MARK DEVER

Nëntë

9

Shenja  
të një  
Kishe  
të Shëndetshme

Mark E. Dever

FOURTH EDITION

525 A Street NE • Washington, DC 20002  
Phone (202) 543-1224, FAX (202) 543-6113  
[www.9Marks.org](http://www.9Marks.org)

Titulli në anglisht *Nine Marks of a Healthy Church*

© 2001 Mark E. Dever

All rights reserved.

Printed in the United States of America by  
9Marks

Titulli në origjinal: 9 Signs of a Healthy Church

Autorja: Mark E. Dever

Përktheu: Shpëtim Lezi

Redaktoi: Afërdita Cesula

Libri është bërë në bashkëpunim mes kishës “Rruga e Paqes” dhe “Kisha e Hirit, Tiranë.

Citimet biblike janë marrë nga Bibla “Diodati i Ri” (1991-1994). E drejta e autorit  
© SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (ABS) TIRANË Përdorur me leje.

Shtypur nga Vernon Publishing

Tiranë, Shqipëri, 2008

Tirazhi: 500 kopje

Amazon ISBN: 978-1727846096

## QENDRA PËR REFORMËN E KISHËS

# Misioni ynë

- E ditur:** Hipokrizia ia humb vlerën kishës.
- E ditur:** Pastërtia e vërtetë e hirshme është një mjet i rëndësishëm për sigurinë, ndërtimin dhe ungjillëzimin. E megjithatë sot, një pastërti e tillë neglizhohet shumë shpesh.
- Atëherë:** Misioni ynë është ta thërrasim kishën që të jetë nusja tërheqëse e Krishtit, të cilën Ai e ka blerë dhe e ka bërë çfarë ajo është. Ne e bëjmë këtë nëpërmjet udhëzimit dhe inkurajimit të pastorëve dhe udhëheqësve të tjerë të kishës.

# Objektivi ynë

Për shkak të rëndësisë së ripërtërirë që po i jepet autoritetit të Shkrimeve mes shumë të krishterëve ungjillorë, të rritjes së laicizmit dhe të zvogëlimit të besnikërisë denominacionale, traditat po vihen gjerësisht në pikëpyetje sot. Ne besojmë se ka një interes dhe, madje, një uri për të rimenduar pikëpamjet për kishën në qarqet ungjillore. Tani është çasti i duhur për ta ripërkufizuar kishën në një mënyrë më të shëndetshme dhe më biblike.

Qendra për Reformën e Kishës kërkon të ndryshojë mënyrën në të cilën pastorët dhe udhëheqësit e kuptojnë kishën lokale. Ne duam ta rifokusojmë vëmendjen te vlera e bashkësive të shëndetshme. Ne duam që të rilidhim teologjinë e kujdesshme biblike me praktikën kishtarë.

QRK-ja siguron një forum edukativ për të diskutuar, për të ekzaminuar dhe për të debatuar për elementet e një kishë lokale shembullore. Përveç mësimit, ne dëshirojmë të paraqesim një model, i cili reformohet vazhdimisht nga Fjala e Perëndisë. Katër kanalet parësore nëpërmjet të cilave kërkojmë të demonstrojmë një model të shëndetshëm të kishës janë:

- **Media:** shërbesa përmes radios, faqes elektronike, kasetave
- **Studimi:** në konferenca, gjatë stazheve, gjatë pushimeve të sabbatit
- **Botimet:** e librave, broshurave, gazetave
- **Misionet:** qendrat kërkimore dhe udhëtimi

# VEPRA TË TJERA NGA KY AUTOR

*Nine Marks of a Healthy Church*, expanded version.  
(Crossway: 2000)

*Richard Sibbes: Puritanism and Calvinism in Late Elizabethan and Early Stuart England* (Mercer University Press: 2000)

*Polity: Biblical Arguments for How to Conduct Church Life: A Collection of Historic Baptist Documents* (CCR: 2001)

*A Display of God's Glory: Basics of Church Structure: Deacons, Elders, Congregationalism, and Membership.* (CCR: 2001)

“The Priesthood of All Believers: Reconsidering Every Member Ministry,” in *The Compromised Church*, ed. John Armstrong (Crossway: 1998)

“Reflections on Providence,” in *Christianity in a Changing World*, ed. Michael Schluter (Marshall Pickering: 2000)

“Communicating Sin in a Postmodern World,” in *Telling the Truth: Evangelizing Postmoderns*, ed. D. A. Carson (Zondervan: 2000)

“Why I am a Baptist,” in *Why I Am A Baptist*, ed. Tom Nettles & Russ Moore (Broadman & Holman: 2001)

“John L. Dagg,” in *Theologians of the Baptist Tradition*, ed. Timothy George and David S. Dockery (Broadman & Holman: 2001)

“Do the Work of an Evangelist,” in *Reforming Pastoral Ministry*, ed. John Armstrong (Crossway: 2001)

“Why We Disciplined Half our Church” in *Leadership Journal* (Fall, 2000)

“Church Discipline,” in the *Southern Baptist Journal of Theology* (Winter 2000)

# Përmbajtja

HYRJE .....	7
<b>1. PREDIKIMI EKSPUZUES .....</b>	<b>9</b>
<b>2. TEOLOGJIA BIBLIKE .....</b>	<b>15</b>
<b>3. NJË KUPTIM BIBLIK I LAJMIT TË MIRË .....</b>	<b>21</b>
<b>4. NJË KUPTIM BIBLIK I K'THIMIT NË BESIM .....</b>	<b>25</b>
<b>5. NJË KUPTIM BIBLIK I UNGJILLIZIMIT .....</b>	<b>29</b>
<b>6. NJË KUPTIM BIBLIK I ANËTARËSISË KISHTARE .....</b>	<b>33</b>
<b>7. DISIPLINA BIBLIKE E KISHËS .....</b>	<b>39</b>
<b>8. PREOKUPIMI PËR NXITJEN E DISHEPULLIZIMIT DHE TË RRIJTJES SË KRISHTERË .....</b>	<b>45</b>
<b>9. UDHËHEQJA KISHTARE BIBLIKE .....</b>	<b>49</b>
PËRFUNDIMI .....	55
SHTOJCË	
NJË BESËLIDHJE TIPIKE E NJË KISHE TË SHËNDETSHME .....	57

*Nëntë Sbenjat të një Kisbe të Shëndetshme*

# Hyrje

Perëndia, në mirësinë dhe dashurinë e Tij, nuk na ka thirrur që të jemi të krishterë të vetmuar. Megjithëse mëkatojmë individualisht, dhe po individualisht thirremi të veçohemi nga bota, ne jemi thirrur gjithashtu që të mblihdemi së bashku në një asamble lokale. Kjo asamble, në Dhiatën e Re, quhet kishë.

Në ditët e sotme, shumë libra që janë në qarkullim dhe shumë folës po pohojnë që pothuajse çdo atribut i mundshëm i përfytyrueshëm, çdo stil adhurimi i përfytyrueshëm, program kompjuteri, libër, qendër zëri, seminar, shërbesë, program edukimi, grup, filozofi, metodë, doktrinë, virtyt, përvojë shpirtërore, projekt vendesh parkimi dhe çdo strukturë menaxhimi e përfytyrueshme, është çelësi drejt një kisha të suksesshme. Kush ka të drejtë? Si mund ta dish nëse një kishë është e shëndetshme? Çfarë mund të bësh për të inkurajuar rritjen biblike të vazhdueshme, e cila lavdëron Perëndinë?

Ky libër i vogël është një mjet për të sjellë ndryshim nëpër kisha. Në të, unë sugjeroj nëntë shenja dalluese të një kisha të shëndetshme. Këto nuk janë atributet e vetme të një kisha të shëndetshme. Ato nuk janë gjithçka që dikush mund të thotë rreth një kisha. Madje, ato nuk janë domosdosmërisht as gjërat më të rëndësishme rreth një kisha. Për shembull, pagëzimi dhe darka e Zotit janë aspektet thelbësore të një kisha biblike, por, megjithatë, ato nuk diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë këtu. Kjo ndodh për shkak se, në të vërtetë, çdo kishë të paktën synon që t'i praktikojë ato. Nëntë atributet që trajtohen këtu janë shenja që mund ta bëjnë një kishë të veçantë, që mund ta dallojnë një kishë biblike të shëndoshë e të shëndetshme nga motrat e saj më shëndetliga. Nëntë shenjat që trajtohen këtu janë shumë të rralla sot dhe prandaj nevojitet që të sillen në vëmendjen tonë dhe të kultivohen në kishat tona.

Natyrisht, ashtu siç nuk ka të krishterë të përsosur në këtë jetë, nuk ka as kisha të përsosura. Edhe kishat më të mira nuk janë ideale. As qeverisja e saktë (e kishës) dhe as predikimi kurajoz, as dhurimi sakrifikues dhe as ortodoksia doktrimore nuk mund të garantojnë që kisha do të lulëzojë. Megjithatë, çdo kishë mund të jetë më e



shëndetshme nga ç'është aktualisht. Për sa kohë jemi gjallë, nuk e shohim asnjëherë fitoren e plotë mbi mëkatin, por, si fëmijë të vërtetë të Perëndisë, ne gjithsesi nuk heqim dorë nga kjo përpjekje. As kishat nuk duhet të heqin dorë nga kjo përpjekje. Të krishterët, veçanërisht pastorët dhe udhëheqësit e kishave, dëshirojnë dhe punojnë shumë për të parë kisha më të shëndetshme. Objektivi i këtij libri është që të inkurajojë një shëndet të tillë. Për këtë qëllim po shkruaj unë dhe për këtë qëllim po lexoni ju, në mënyrë që Perëndia të mund të përlëvdohet në popullin e Tij.

Fiksimi ynë (në Amerikë) pas pragmatizmit, sidomos ndaj suksesit të dukshëm, duhet zëvendësuar nga një mbështetje e përvulluar, besimplotë te besnikëria ndaj Perëndisë, sidomos në ndjekjen e urdhëresave të Tij, pavarësisht nga reagimi i çastit që mund të kenë njerëzit. Ne duhet të kemi disa kategori për të dalluar dhe për të inkurajuar përpjekjet jo vetëm të një mbjellësi kishash në zona demografikisht në rritje apo në mes të një rizgjimi, por edhe të pastorëve besnikë në zona rurale dhe në qytete demografikisht të stabilizuara ose në rënie. Duhet të jemi në gjendje që të inkurajojmë punën e Perëndisë ashtu siç ajo është parë edhe në përpjekjet e Uilliam Kerit apo të Adoniram Judsonit dhe jo vetëm përpjekjet e bëra në kryqëzata apo misione, ku ka një numër të madh njerëzish që përgjigjen menjëherë pozitivisht ndaj mesazhit.

Një gjë që duhet pasur kujdes: në këtë rikalibrim të qëllimeve dhe të praktikave të kishave tona, ne nuk duhet të mbështetemi te seminarët, si mjete të ndryshimit dhe të reformës biblike. Seminarët (qofshin ato denominacionale ose të tjera) janë institucione që i marrin përgjegjësitë nga njerëzit që i mbështesin, dhe ata duhet të qëndrojnë besnikë ndaj tyre, ose të zhbëhen. Kjo është ashtu siç duhet të jetë. Prandaj, ne duhet të punojmë për një ndryshim më të ngadaltë dhe më të gjatë ndërsa përpiqemi të ndryshojmë kishat tona.

Sërisht, edhe kishat më të mira nuk janë ideale, por gjithsesi, nuk duhet të ndalojmë së punuari. Ne jemi të bashkuar në dëshirën tonë për kisha më të shëndetshme, ku Perëndia do të përlëvdohet në popullin e Tij. Uroj që ky libër të përdoret për këtë qëllim.

# 1

## **Predikimi ekspozues**

- I. PËRKUFIZIMI I PREDIKIMIT EKSPOZUES
- II. PREDIKIMI EKSPOZUES, JO KREJTËSISHT NJË STIL
- III. NËNSHTRIM NDAJ FJALËS SË PERËNDISË, JO NDAJ NJOHU RISË SË VETË PREDIKUESIT
- IV. PERËNDIA GJITHNJË I KA KRIJUAR NJERËZIT E TIJ ME ANË TË FJALËS SË TIJ
- V. VENDI QENDROR I FJALËS SË PREDIKUAR TË PERËNDISË
- VI. PYETJE PËR REFLEKTIM

Pikënisja është fillimi i Perëndisë me ne – Ai na ka folur. Kjo është mënyra se si ka ardhur shëndeti ynë shpirtëror dhe gjithashtu edhe mënyra se si do të vijë shëndeti i kishës. Veçanërisht i rëndësishëm për këdo që është në udhëheqje në kishë, por sidomos për pastorin e kishës, është përkushtimi ndaj predikimit ekspozues, një nga metodat më të vjetra të predikimit. Ky është ai lloj predikimi që ka si objekt të shtjellojë atë që është thënë në një pasazh të Shkrimit, duke shpjeguar me kujdes kuptimin e tij dhe duke e zbatuar atë për bashkësinë (shih Nehemia 8:8). Natyrisht, ka shumë lloje të tjera predikimi. Predikimet tematike, për shembull, përmbledhin gjithë mësimin e Shkrimit në një temë të vetme, si lutja ose dhurimi. Predikimi biografik trajton jetën e një njeriu në Bibël dhe e përshkruan atë si një shfaqje të hirit të Perëndisë dhe si një shembull të shpresës dhe të besnikërisë. Por predikimi ekspozues është diçka tjetër – një shpjegim dhe zbatim i një pjese të veçantë të Fjalës së Perëndisë.

Predikimi ekspozues presupozon një besim në autoritetin e Shkrimit, por është diçka më tepër se aq. Përkushtimi ndaj predikimit

ekspozues është një përkushtim për të dëgjuar Fjalën e Perëndisë. Ashtu si profetëve të Dhiatës së Vjetër dhe apostujve të Dhiatës së Re iu dha një detyrë jo vetëm për të shkuar dhe folur, por iu dha një mesazh i veçantë, ashtu edhe predikuesit e krishterë sot kanë autoritetin për të folur nga Perëndia, për aq kohë sa flasin sipas fjalës së Tij. Kështu, autoriteti i predikuesit ekspozues fillon dhe përfundon me Shkrimet. Nganjëherë njerëzit mund ta ngatërrojnë predikimin ekspozues, me stilin e një predikuesi ekspozues të preferuar, por kjo nuk është në thelb një çështje stili. Siç e kanë vërejtur edhe të tjerë, predikimi ekspozues, në fund të fundit, ka të bëjë me mënyrën se si i themi ato që themi, por me mënyrën se si vendosim se çfarë duhet të themi. Ai nuk dallohet nga një formë e veçantë, por nga përmbajtja biblike.

Dikush mund të pranojë me dëshirë autoritetin e Fjalës së Perëndisë dhe madje të deklarojë se beson në pagabueshmërinë e Biblës; megjithatë, nëse në praktikë (pavarësisht nëse e bën qëllimisht ose jo) nuk predikon në mënyrë ekspozuese, ai nuk do të predikojë asgjë më shumë nga ajo çfarë di tashmë. Një predikues mund të marrë një pjesë të Shkrimit dhe ta këshillojë bashkësinë për një temë që është e rëndësishme pa predikuar realisht mësimin e pasazhit. Kur ndodh kjo, predikuesi dhe bashkësia dëgjojnë nga Shkrimet vetëm atë që tashmë e dinë.

Në dallim nga kjo, kur në mënyrë ekspozuese predikojmë një pasazh të Shkrimeve në kontekstin e vet – duke e marrë mësimin e pasazhit si mësimin e mesazhit – ne dëgjojmë nga Perëndia gjëra që nuk mendonim se do t'i dëgjonim kur filluam. Që nga thirrja fillestare për t'u penduar deri te ato fusha të jetës sonë për të cilat na ka bindur Fryma kohët e fundit, gjithë shpëtimi ynë konsiston në dëgjimin e Perëndisë në mënyra të cilat, para se ta dëgjonim Atë, nuk do t'i kishim parafytyruar kurrë. Ky nënshtrim shumë praktik ndaj Fjalës së Perëndisë duhet të jetë i dukshëm në shërbesën e një predikuesi.

Por të jeni të qartë për diçka: është përgjegjësia e bashkësisë, në fund të fundit, që të sigurohet që të ndodhë kështu. (Vini re përgjegjësinë që kërkon Jezusi nga bashkësia te Mateu 18, apo Pali te 2Timoteut 4). Një kishë nuk duhet ta ngarkojë kurrë një person me

mbikëqyrjen shpirtërore të tufës, nëse ai nuk tregon në praktikë një përkushtim për të dëgjuar dhe për të dhënë mësim Fjalën e Perëndisë. Ta bësh këtë do të thotë pashmangshmërisht që ta pengosh rritjen e kishës dhe praktikisht ta inkurajosh atë të rritet vetëm deri në nivelin e pastorit. Në një rast të tillë, kisha dalëngadalë do të përshtatet me mendimet e tij dhe jo me mendimet e Perëndisë.

Njerëzit e Perëndisë janë krijuar gjithnjë nga Fjala e Perëndisë. Që nga krijimi të Zanafilla 1 e deri te thirrja e Abramit të Zanafilla 12, nga vizioni i luginës së eshtrave të thata tek Ezeieli 37 e deri te ardhja e Fjalës së gjallë, Perëndia gjithnjë i ka krijuar njerëzit e Tij me anë të Fjalës së Tij. Siç u shkruan Pali Romakëve: “Besimi vjen nga dëgjimi i mesazhit, dhe mesazhi dëgjohej përmes fjalës së Krishtit,” (10:17 NIV). Ose, siç u shkruan Korintasve: “Duke qenë se nëpërmjet diturisë së Perëndisë bota nuk e njohu Perëndinë me urtinë e vet, Perëndisë i pëlqeu të shpëtojë ata që besojnë nëpërmjet marrëzisë së predikimit,” (1Korintasve 1:21)

Predikimi i shëndoshë ekspozues shpesh është burimi i rritjes në kishë. Në eksperiencën e Martin Luterit, një vëmendje e tillë e kujdesshme ndaj fjalës së Perëndisë ishte fillimi i reformimit. Edhe ne, gjithashtu, duhet të jemi të përkushtuar që të jemi kisha që po reformohen gjithnjë sipas Fjalës së Perëndisë.

Një herë, kur po jepja mësim në një seminar njëditor mbi puritanizmin në një kishë në Londër, përmenda faktin se predikimet puritane ishin nganjëherë dy orë të gjata. Pas këtij komenti, dikush i habitur pyeti: “Sa kohë mbetej pastaj për adhurimin?” Shqetësimi kishte të bënte me faktin se dëgjimi i fjalës së Perëndisë të predikuar nuk përbënte adhurim. Unë iu përgjigja se shumë të krishterë anglezë protestantë do ta kishin konsideruar dëgjimin e fjalës së Perëndisë në gjuhën e tyre dhe zbatimin e saj në jetën e tyre si një pjesë thelbësore të adhurimit të tyre. Fakti nëse ata kishin kohë për të kënduar së bashku kishte pak rëndësi për ta.

Kishat tona duhet të rivendosin Fjalën në qendër të adhurimit. Dëgjimi i fjalës së Perëndisë dhe përgjigja ndaj saj mund të përfshijë lavdërimin dhe falënderimin, rrëfimin dhe shpalljen dhe çdonjëra prej këtyre mund të jetë në këngë, por jo në mënyrë të domosdoshme.

Një kishë e ndërtuar mbi muzikën – e çfarëdo stili – është një kishë e ndërtuar mbi një rërë thithëse. Predikimi është përbërësi themelor i shërbesës pastorale. Lutuni për pastorin tuaj, që ai t'i përkushtohet studimit të Shkrimeve në mënyrë rigoroze, të kujdesshme dhe serioze, dhe që Perëndia ta udhëheqë atë në kuptimin e Fjalës, në zbatimin e saj në jetën e tij, dhe në zbatimin e saj për kishën (shih te Lluca 24:27; Veprat 6:4; Efesianëve 6:19-20). Nëse jeni pastor, lutuni për këto gjëra për veten tuaj. Lutuni gjithashtu për të tjerët që predikojnë dhe japin mësim Fjalën e Perëndisë. Së fundi, lutuni që kishat tona të jenë të përkushtuara për të dëgjuar Fjalën e Perëndisë të predikuar në mënyrë ekspozuese, në mënyrë që plani i punës i çdo kishe të marrë trajtë gjithnjë e më shumë nga plani i Perëndisë në Shkrime. Përkushtimi ndaj predikimit ekspozues është shenjë e një kishe të shëndetshme.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Lexoni Nehemian 8:7-8. Çfarë thotë Bibla për atë që bënë levitët për njerëzit ndërsa u lexuan atyre Librin e Ligjit? Në vargun 12, thuhet se, pas takimit, njerëzit u larguan duke kremtuar me hare të madhe. Sipas pasazhit, pse po kremtonin ata?

2. Autori e përkufizon predikimin ekspozues si “një shpjegim dhe zbatim të një pjese të veçantë të Fjalës së Perëndisë”. Riformulojeni këtë përkufizim me fjalët tuaja. Çfarë e dallon predikimin ekspozues nga llojet e tjera të predikimit, si për shembull, ai tematik apo biografik?

3. Te Veprat e Apostujve 20:27, Pali u thotë Efesianëve se ai ka punuar për t'u predikuar atyre “gjithë këshillën e Perëndisë”. Duke e kuptuar se puna jonë si udhëheqës të kishës është që të bëjmë të njëjtën gjë për njerëzit tanë, si mund të na sjellë përfitime predikimi ekspozues në përpjekjen tonë për ta paraqitur gjithë këshillën e Perëndisë para njerëzve në kishë? Cili është rreziku nëse ne nuk “e marrim mësimin e pasazhit si mësim të mesazhit tonë”?

4. Nga Zanafilla 1 e deri në Dhiatën e Re, Perëndia gjithnjë i ka krijuar njerëzit e Tij me anë të Fjalës së Tij. Lexoni Romakëve 10:17 dhe 1Korintasve 1:21. Çfarë përdor Perëndia për t'i sjellë njerëzit e Tij te besimi shpëtues në Krishtin? Çfarë na thotë kjo për vlerësimin që duhet të kemi për Fjalën e Perëndisë në kishat tona? Si duhet të manifestohet praktikisht ky vlerësim në predikimin tonë?

*Nëntë Sbenjat të një Kisbe të Shëndetsbme*

# 2

## Teologjia biblike

- I. “DOKTRINA E SHËNDOSHË”
- II. UNITETI, LARMIA, DHE DASHURIA
- III. TRAJTIMI I DOKTRINAVE KOMPLEKSE OSE POLEMIZUESE
- IV. REZISTENCA NDAJ SOVRANITETIT TË PERËNDISË
- V. UDHËHEQËSIT DUHET TË PËRQAFOJNË SOVRANITETIN E PERËNDISË
- VI. PYETJE PËR REFLEKTIM

Predikimi ekspozues është i rëndësishëm për shëndetin e një kisha. Megjithatë, çdo metodë, sado e mirë qoftë ajo, është e hapur ndaj abuzimeve dhe prandaj duhet të jetë e hapur për t'u testuar. Në kishat tona, shqetësimi ynë duhet të jetë jo vetëm për mënyrën si mësohemi, por edhe për atë që na mësohet. Duhet ta çmojmë doktrinën e shëndoshë, sidomos në të kuptuarit e Perëndisë së Biblës dhe të mënyrave se si Ai vepron me ne.

Në letrat e Palit drejtuar Timoteut dhe Titit, fjala “e shëndoshë” do të thotë e besueshme, e saktë ose besnike. Në rrënjën e vet, kjo fjalë është një imazh nga bota e mjekësisë që do të thotë e plotë ose e shëndetshme. Te 1Timoteut 1 lexojmë se doktrina e shëndoshë e merr trajtën nga ungjilli dhe se ajo është kundër paperëndishmërisë dhe mëkatit. Akoma më qartë, te 1Timoteut 6:3, Pali bën krahasimin e “doktrinave të rreme” me “këshillën e shëndoshë të Zotit tonë Jezu Krisht dhe... mësimin e perëndishëm”. Prandaj, në letrën e tij të dytë drejtuar Timoteut, Pali e këshillon atë: “Ruaje modelin e fjalëve të shëndosha që dëgjove prej meje” (2Timoteut 1:13). Pali e paralajmëron Timoteun se “do të vijë koha kur njerëzit nuk do ta durojnë doktrinën



e shëndoshë, por, sipas ëndjeve të veta, do të mbledhin grumbull mësues për të gudulisur veshët” (2Timoteut 4:3).

Kur Pali i shkroi një tjetër pastori të ri, Titit, ai shprehu shqetësimet e ngjashme. Çdo njeri, të cilin Titi do ta emëronte si plak kishe, Pali thotë se duhet “të mbajë fort fjalën besnike siç i është mësuar, që të jetë në gjendje me doktrinën e shëndoshë të këshillojë dhe bindë ata që kundërshtojnë” (Titit 1:9). Pali e nxiti Titin që të qortojë mësuesit e rremë “që (ata) të shëndoshen në besim” (Titit 1:13). Pali e porosit atë duke i thënë: “Ti shpall ato që përkojnë me doktrinën e shëndoshë” (Titit 2:1).

Nëse do të ekspozonim çdo gjë që përbën mësim të shëndoshë, ne do të riprodhonim gjithë Biblën. Por në praktikë, çdo kishë vendos për çështjet mbi të cilat duhet të ketë marrëveshje të plotë, për ato në të cilat mund të ketë mosmarrëveshje të kufizuara dhe për ato në të cilat mund të ketë liri të plotë.

Në kishën ku unë shërbej, në Uashington DC, ne i kërkojmë çdo personi që do të jetë anëtar, të besojë vetëm në shpëtimin përmes veprës së Jezu Krishtit. Gjithashtu kemi të njëjtin kuptim (ose shumë të ngjashëm) për pagëzimin e besimtarit dhe për qeverisjen e kishës. Uniformiteti në këto dy pikat e fundit nuk është thelbësor për shpëtimin, por marrëveshja për to vlen praktikisht dhe është e shëndetshme për jetën e kishës.

Ne mund të lejojmë njëfarë mosmarrëveshje për çështje që nuk duken të domosdoshme as për shpëtimin dhe as për jetën praktike të kishës. Kështu, për shembull, megjithëse ne të gjithë jemi dakord se Krishti do të kthehet, nuk çuditemi që ka mosmarrëveshje mes nesh rreth kohës së kthimit të Tij. Ne mund të gëzojmë liri të plotë për çështje akoma më pak qendrore apo të qarta, të tilla si, drejtësia e rezistencës me armë, apo autorësia e letrës së Hebrenjve.

Në gjithë këtë, parimi duhet të jetë i qartë: sa më pranë thelbit të besimit tonë të afrohem, aq më tepër presim të shohim unitetin tonë të shprehur në të kuptuarit e përbashkët të besimit. Kisha e hershme e ka formuluar kështu: në gjërat thelbësore - unitet, në gjërat jothelbësore larmi dhe në të gjithë gjërat dashuri.

Mësimi i shëndoshë përfshin një përkushtim të qartë ndaj doktrinave shpesh të lëna pas dore, por qartësisht biblike. Nëse duam ta

mësojmë doktrinën e shëndoshë të Biblës, duhet të pranojmë doktrina që mund të jenë të vështira, apo edhe potencialisht përçarëse, por që janë themelore për të kuptuar punën e Perëndisë në mesin tonë. Për shembull, doktrina biblike e përzgjedhjes shpesh shmanget si tepër e ndërlikuar, ose si tepër pështjelluese. Mund të jetë e tillë, por është e pamohueshme që kjo doktrinë është biblike dhe e rëndësishme. Ndërkohë që kjo doktrinë mund të ketë ndërlikime, të cilat nuk i kuptojmë plotësisht, nuk është çështje e parëndësishme që në fund të fundit, shpëtimi ynë vjen nga Perëndia dhe jo nga vetja jonë. Më poshtë janë disa pyetje të tjera të rëndësishme të lëna pas dore, të cilave Bibla u jep përgjigje:

- A janë njerëzit të këqij apo të mirë në thelb? A kanë nevojë thjesht për inkurajim dhe vetë-respekt më të madh, apo kanë nevojë për falje dhe për një jetë të re?
- Çfarë realizoi Jezusi duke vdekur në kryq? A bëri të mundur një alternativë, apo Ai që zëvendësuesi ynë?
- Çfarë ndodh kur dikush bëhet i krishterë?
- Nëse jemi të krishterë, a mund të jemi të sigurt se Perëndia do të vazhdojë të kujdeset për ne? Nëse po, kujdesi i Tij i vazhdueshëm bazohet te besnikëria jonë apo te besnikëria e Tij?

Të gjitha këto pyetje nuk janë thjesht çështje për teologët studiues apo për studentët e rinj të seminareve. Ato janë të rëndësishme për çdo të krishterë. Ata që janë pastorë e dinë se sa ndryshe do t'i drejtonim besimtarët e kishës nëse përgjigjja do të ndryshonte. Besnikëria ndaj Shkrimeve kërkon që ne të flasim për këto çështje me qartësi dhe autoritet.

Të kuptuarit e asaj që Bibla na mëson rreth Perëndisë është shumë i rëndësishëm. Perëndia biblik është Krijues dhe Zot; megjithatë, sovraniteti i Tij nganjëherë mohohet, madje edhe brenda kishës. Që të krishterët e deklaruar të kundërshtojnë idenë e sovranitetit të Perëndisë në krijim ose shpëtim do të thotë në të vërtetë se po luajnë me paganizmin e përsëritshëm. Shumë të krishterë mund të kenë pyetje të sigjerta rreth sovranitetit të Perëndisë, por një mohim i vazhdueshëm kokëfortë i sovranitetit të Perëndisë duhet të na

shqetësojë. Të pagëzosh një person të tillë mund të jetë njësoj si të pagëzosh një zemër që është në njëfarë mënyre akoma jobesimtare. Të pranosh një person të tillë në anëtarësi mund të jetë njësoj si t'i trajtosh ata si njerëz që i zënë besë Perëndisë, kur në fakt është ndryshe.

Sado e rrezikshme të jetë një rezistencë e tillë te çdo i krishterë, ajo është akoma më e rrezikshme te udhëheqësi i një bashkësie. Të emërosh një person si udhëheqës, kur ai dyshon në sovranitetin e Perëndisë ose kur ai e keqkupton shumë seriozisht mësimin biblik për këto çështje, do të thotë të vendosësh si shembull një person që mund të jetë thellë-thellë i pavullnetshëm për t'i zënë besë Perëndisë. Një emërim i tillë, domosdo, do ta pengojë kishën.

Shpesh sot, kultura jonë na inkurajon që ta kthejmë unguillizimin në reklamë dhe e shpjegon punën e Frymës me gjuhën e marketingut. Vetë Perëndia shndërrohet sipas imazhit të njeriut. Në raste të tilla, një kishë e shëndetshme duhet të jetë tepër e kujdesshme për t'u lutur për udhëheqësit që kanë një kuptim biblik dhe jetësor të sovranitetit të Perëndisë dhe një përkushtim ndaj doktrinës së shëndoshë, në lavdinë e saj të plotë biblike. Një kishë e shëndetshme karakterizohet nga predikimi ekspozues dhe nga një teologji biblike.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Lexoni 1Timoteut 6:3-5. Si e përshkruan Pali një person që u mëson të tjerëve “doktrinën e rremë?” Pse mendoni se ishte kaq e rëndësishme për Palin që Timoteu t'u jepte besimtarëve “këshillën e shëndoshë” dhe “mësimin e perëndishëm”?

2. Autori përmend një sërë doktrinash që një person duhet të besojë, me qëllim që të bëhet anëtar i kishës ku shërben. Ai, gjithashtu, rendit një sërë çështjesh, në të cilat anëtarët gëzojnë një liri të konsiderueshme besimi. Çfarë duhet të besojë një person, me qëllim që të bëhet anëtar i kishës suaj? Si e dallojnë këto besime kishën tuaj nga kishat e tjera që gjenden në zonën tuaj? Cilat janë çështjet për të cilat kisha juaj lejon njëfarë lirie?

3. Disa doktrina që janë, pa dyshim, të pranishme në Shkrime shpesh shpërfillen ose neglizhohen, sepse kanë rezultuar si shumë të vështira, polemizuese ose edhe përçarëse. A është polemika e mundshme një arsye e fortë që ne të shmangim bisedën dhe mësimin rreth këtyre doktrinave në kishat tona? Pse ose pse jo?

4. Autori rendit katër pyetje në faqen 19 të cilat shpesh nuk kanë marrë atë vëmendje që meritojnë. Sipas mendimit tuaj, si u përgjigjet Bibla këtyre pyetjeve? Jepni referencat biblike për përgjigjet tuaja.

5. Pali shkruan te Titit 1:9 se udhëheqësi i një bashkësie “duhet ta mbajë fort fjalën besnike siç i është mësuar”. A mendoni se është e rëndësishme, për një pastor ose plak kisha, që të kuptojë dhe të përqafojë sovranitetin e Perëndisë në shpëtim? Cili është rreziku që vjen nga një udhëheqës kisha, i cili e vë në dyshim sovranitetin e Perëndisë në këtë fushë ose e keqkupton mësimin biblik mbi këtë çështje?

*Nëntë Sbenjat të një Kisbe të Shëndetsbme*

# 3

## Një kuptim biblik i lajmit të mirë

- I. UNGJILLI ËSHTË ZEMRA E KRISHTERIMIT
- II. PERËNDIA, NJERIU, KRISHTI, PËRGJIGJJA
- III. UNGJILLI ËSHTË NJË OFERTË RADIKALE PËR SHPËTIM
- IV. PYETJE PËR REFLEKTIM

Është tepër e rëndësishme që të kemi një teologji biblike në një fushë të veçantë të jetës së kishës – në të kuptuarit e lajmit të mirë të Jezu Krishtit, ungjillit. Ungjilli është zemra e krishterimit, dhe prandaj duhet të jetë edhe zemra e besimit tonë. Të gjithë ne si të krishterë duhet të lutemi që të kujdesemi për lajmin e mirë e të mrekullueshëm të shpëtimit përmes Krishtit, më tepër sesa për çdo gjë tjetër në jetën e kishës. Një kishë e shëndetshme është e mbushur me njerëz që kanë një zemër për ungjillin, dhe të kesh një zemër për ungjillin, do të thotë që të kesh një zemër për të vërtetën – për prezantimin që Perëndia i bën vetes, nevojës sonë, dhuratës së Krishtit dhe përgjegjesisë sonë.

Kur ia prezantoj ungjillin dikujt, përpiqem të mbaj mend katër pika: Perëndia, njeriu, Krishti, përgjigja. A ia kam thënë këtij personi të vërtetën rreth Perëndisë së Shenjtë dhe Krijuesit Sovran? A e kam bërë të qartë se ne si njerëz jemi një përzierje e çuditshme, krijesa të bëra në imazhin e Perëndisë, por edhe të rënë nga kjo lavdi, mëkatarë dhe të ndarë prej Tij? A e kupton personi me të cilin po bisedoj se cili është Krishti – Perëndia-njeri, ndërmjetësi i vetëm mes Perëndisë dhe njeriut, zëvendësuesi ynë dhe Zoti i ringjallur? Dhe, së fundi, edhe nëse e kam ndarë gjithë këtë informacion me të, a e kupton ai se duhet

të japë një përgjigje ndaj ungjillit, se ai duhet ta besojë këtë mesazh dhe kështu të largohet nga jeta e egoizmit dhe e mëkatit?

Ta paraqesësh ungjillin si një shtesë, për t'u dhënë jo të krishterëve diçka që ata natyrisht e duan (gëzim, paqe, lumturi, përmbushje, vetërespekt, dashuri), është pjesërisht e vërtetë, por vetëm pjesërisht e vërtetë. Siç shprehet J. I. Pakeri: “Një gjysmë e vërtetë që paraqitet e maskuar si gjithë e vërteta bëhet një e pavërtetë e plotë”. Në thelb, çdo njeri ka nevojë për falje. Ne kemi nevojë për jetën shpirtërore. Ta paraqesësh ungjillin në mënyrë më pak radikale sesa kaq do të thotë të kërkojë kthimë të rreme në besim dhe anëtarësi kishë gjithnjë e më të pakuptimtë, dy gjëra që e bëjnë ungjillëzimin e botës përreth nesh akoma më të vështirë.

Anëtarët tanë të kishës, të shpërndarë nëpër shtëpi, zyra dhe lagje, edhe sot që po flasim, do të takojnë shumë më tepër jo të krishterë, për një kohë shumë më të gjatë, sesa gjithë koha që do të kalojnë me të krishterët në një të diel. Secili nga ne ka lajmin e jashtëzakonshëm të shpëtimit në Krishtin. Le të mos e këmbejmë atë për diçka tjetër. Dhe le ta bëjmë të ditur sot! Xhorxh V. Trueti, udhëheqësi i madh i krishterë i brezit të kaluar dhe pastor i Kishës së Parë Baptiste të Dallasit, në Teksas, ka thënë:

Akuza kryesore që mund t'i bëhet një kishë... është se asaj kishë i mungon pasioni dhe dhembshuria për shpirtrat njerëzorë. Kisha nuk është asgjë më shumë sesa një klub etik, nëse keqardhja e saj për shpirtrat e humbur nuk është e madhe dhe nëse kjo keqardhje nuk vërshon, në përpiqje për t'i orientuar shpirtrat e humbur drejt njohjes së Jezu Krishtit.

Një kishë e shëndetshme e di lajmin e mirë dhe e ndan atë me të tjerët.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Autori beson se ne si të krishterë duhet të kujdesemi për lajmin e mirë të shpëtimit përmes Krishtit, më tepër sesa për çdo gjë tjetër në jetën e kishës. A jeni dakord me këtë? Lexoni 1Korintasve 2:2. Pse është kaq i rëndësishëm mesazhi i Jezu Krishtit?

2. Për të pasur një kuptim biblik të ungjillit, çfarë duhet të kuptojë një person rreth Perëndisë? Çfarë duhet të kuptojë një person rreth njeriut dhe gjendjes së tij në mëkat? Çfarë duhet të kuptojë një person rreth Krishtit? Sipas Jezusit te Marku 1:15, cila duhet të jetë përgjigja e njeriut ndaj lajmit të mirë? Çfarë përfshihet në secilën prej dy pjesëve kryesore të asaj përgjigjeje?

3. Autori shkruan se “ta paraqesësh ungjillin në mënyrë më pak radikale sesa kaq do të thotë që të kërkosh kthime të rreme në besim dhe anëtarësi kisha gjithnjë e më të pakuptimtë”. Cili është ky mesazh “radikal” i ungjillit? Si ndryshon kjo gjë nga mënyra se si paraqitet nganjëherë ungjilli, si një mënyrë që jo të krishterët të jenë më të lumtur dhe të ndihen më mirë për veten e tyre?

4. Në ç’pozicion është kisha juaj ndaj sfidës së Xhorxh V. Truetit në faqet e mësipërme? Sa e zjarrtë është kisha juaj për të ndarë lajmin e mirë të shpëtimit përmes Krishtit me njerëzit e humbur?



*Nëntë Sbenjat të një Kisbe të Shëndetsbme*

# 4

## Një kuptim biblik i kthimit në besim

- I. PENDIMI DHE BESIMI
- II. KTHIMI NË BESIM ËSHITË PUNA E PERËNDISË  
BRENDA NESH
- III. “TI NUK JE NJË NJERI I ZOTTI!”
- IV. “DËSHMIA E KUNDËRT” E KISHËS
- V. KTHIMI NË BESIM I DËSHMUAR NGA FRYTET E TIJ
- VI. PYETJE PËR REFLEKTIM

Në takimin e parë të kishës sonë, në vitin 1878, ne miratuam një deklaratë besimi. Ajo ishte një version i përforcuar i Deklaratës së Besimit të bërë në Nju Hampshir në vitin 1833. Kjo deklaratë u bë baza për Mesazhin dhe Besimin Baptist, të miratuar nga Konventa Jugore Baptiste në vitin 1925 dhe sërish, në një version të ndryshuar dhe më të dobët se i pari, në vitin 1963. Në deklaratën tonë të besimit, Neni VIII thotë:

Ne besojmë se Pendimi dhe Besimi janë detyra të shenjta dhe, gjithashtu, hire të pandashme, të krijuara në shpirtin tonë nga Fryma ripërtëritëse e Perëndisë; dhe, si rrjedhojë, të bindur thellë për fajin, rrezikun dhe pafuqishmërinë tonë, dhe për rrugën e shpëtimit përmes Krishtit, ne kthehemi te Perëndia me keqardhje të sinqertë, rrëfim dhe me lutje të vërtetë për mëshirë; në të njëjtën kohë, pranojmë me gjithë zemër Zotin Jezu Krisht si Profetin, Priftin dhe Mbretin tonë, dhe mbështetemi vetëm tek Ai si Shpëtimtari i vetëm dhe plotësisht i mjaftueshëm.

Vini re se çfarë thotë kjo deklaratë rreth kthimit tonë në besim. Ne kthehemi sepse jemi “të bindur thellë për fajin, rrezikun dhe pafuqishmërinë tonë, dhe për rrugën e shpëtimit përmes Krishtit”. Dhe si ndodh ky kthim – që përbëhet nga pendimi dhe besimi? Ai “krijohet në shpirtin tonë nga Fryma ripërtëritëse e Perëndisë”. Më pas, deklarata citon dy pjesë nga Shkrimet për të mbështetur këtë ide: Veprat 11:18: “Si i dëgjuan këto fjalë, ata u qetësuan dhe përlëvdonin Perëndinë, duke thënë: ‘Perëndia, pra, edhe johebrenjve u dha pendesën për t’u dhënë jetën” dhe Efesianëve 2:8: “Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhuratë e Perëndisë”.

Nëse kthimi në besim kuptohet, në thelb, si diçka që ne e bëjmë vetë dhe jo si diçka që Perëndia e realizon brenda nesh, atëherë ne e kemi keqkuptuar atë. Kthimi në besim sigurisht e përfshin veprimin tonë – ne duhet të bëjmë një përkushtim të sinqertë, të marrim një vendim të vetëdijshëm. Megjithatë, kthimi në besim është shumë më tepër sesa kaq. Bibla është e qartë në mësimin e saj se nuk jemi duke udhëtuar të gjithë drejt Perëndisë, disa prej nesh e kanë gjetur rrugën, ndërsa të tjerët po kërkojnë akoma. Përkundrazi, ajo na paraqet ne si njerëz që kemi nevojë për zëvendësim të zemrës, për transformim të mendjes dhe për rilindje të shpirtit tonë. Asnjërin prej këtyre gjërave nuk mund ta bëjmë vetë. Ne mund të bëjmë një përkushtim, por ne duhet të shpëtohemi. Ndryshimi për të cilin ka nevojë çdo njeri, pavarësisht se si mund të dukemi nga ana e jashtme, është kaq radikal, kaq rrënjësor, sa që vetëm Perëndia mund ta bëjë atë. Ne kemi nevojë për Perëndinë për të na kthyer në besim.

Më vjen ndërmend historia e Spërzhënit në të cilën ai tregon se kur po ecte nëpër Londër, një njeri i dehur erdhi tek ai, u mbështet te një shtyllë dritash dhe tha: “Hej, zoti Spërzhën, unë jam një nga të kthyerit tuaj në besim”! Spërzhëni iu përgjigj: “Ti duhet të jesh vërtet i imi – sigurisht ti nuk je i Zotit”!

Një rezultat i keqkuptimit të mësimit të Biblës për kthimin në besim mund të jetë ai se kishat ungjillore janë plot me njerëz që kanë bërë një përkushtim të sinqertë në një moment të jetës së tyre, por që

në të vërtetë, nuk e kanë përjetuar ndryshimin rrënjësor, të cilin Bibla e paraqet si kthim në besim.

Sipas një studimi të kohëve të fundit nga Konventa Jugore Baptiste, Baptistët Jugorë (denominacioni im) kanë një përqindje divorci që është mbi mesataren kombëtare në Amerikë. Shkaku i një “dëshmie të tillë të kundërt” mes ndjekësve të respektuar të Krishtit duhet të jetë, të paktën pjesërisht, predikimi jobiblik rreth kthimit në besim.

Sigurisht, kthimi në besim nuk ka pse të jetë një eksperiencë emocionalisht e fortë, por ajo duhet të vërtetohet nga frytet e saj, në mënyrë që të jetë kthim i vërtetë në besim sipas mësimit të Biblës. Të kuptuarit e prezantimit që Bibla i bën kthimit në besim është një nga shenjat e kishës së shëndetshme.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Lexoni Veprat 11:18. Çfarë na mëson ky pasazh rreth origjinës bazë të pendimit? A është pendimi në thelb një rezultat i vendimit të njëanshëm të njeriut për t'u kthyer te Perëndia, apo është rezultat i punës ripërtëritëse të Perëndisë në zemrën e njeriut?

2. Lexoni Zanafillën 6:5 dhe Romakëve 8:7. Përshkruani gjendjen e zemrës njerëzore nën mëkat. Si e paraqet Bibla aftësinë e njeriut për ta kënaqur Perëndinë ose për të vetëvendosur për t'u kthyer tek Ai?

3. Lexoni Efesianëve 2:1-10. Perëndia shkakton një ndryshim të madh në zemrën tonë gjatë kthimit në besim. Si e përfaqëson ky pasazh këtë ndryshim? A është kjo diçka që njeriu mund ta prodhojë te vetja e tij përmes përpjekjeve të mëdha?

4. Sondazhet e fundit raportojnë se të krishterët që deklarohen si ungjillorë në Amerikë sot kanë një përqindje divorci që është më e lartë sesa mesatarja kombëtare. Cila mund të jetë njëra nga arsyet për këtë? Çfarë mësimi jep Bibla për disa nga faktet ose “frytet” e punës ripërtëritëse të Frymës së Perëndisë në jetën e një personi?

5. Në shekujt e mëparshëm, besimtarët pagëzoheshin më tepër kur arrinin moshën madhore (pra, në moshën 17-20 vjeç). Çfarë mund ta shpjegojë zbritjen e kësaj moshe mes të krishterëve baptistë në këtë shekull të fundit? Pse është kjo domethënëse?

# 5

## Një kuptim biblik i ungjillëzimit

- I. PASOJAT E NEGLIZHIMIT
- II. UNGJILLËZIMI QË E KA MARRË TRAJTËN NGA TË KUPTUARIT E KTHIMIT NË BESIM
- III. PËRKUFIZIMI I UNGJILLËZIMIT
- IV. ËSHTË PERËNDIA AI QË I KTHEN NJERËZIT NË BESIM
- V. KUR ANËTARËSIA ËSHTË SHUMË MË E MADHE SESA PJESËMARRJA
- VI. TRE TË VËRTETA QË DUHEN PËRÇUAR
- VII. BURIMET
- VIII. PYETJE PËR REFLEKTIM

Për të bërë një përmbledhje, deri tani, ndërmjet shenjave që e dallojnë një kishë të shëndetshme, kemi analizuar: predikimin ekspozues, teologjinë biblike dhe një kuptim biblik të ungjillit dhe të kthimit në besim. Një mënyrë për të dalluar se sa të rëndësishme janë këto është që të shqyrtojmë pasojat për bashkësitë që i humbasin ato. Predikimet fare lehtë mund të bëhen përsëritje bajate të të vërtetave që dihen tashmë. Krishterimi mund të bëhet i padallueshëm nga kultura shekullare përreth. Ungjilli mund të rimodelohet në një trajtë që nuk është më shumë sesa ndihmë vetëshpirtërore. Kthimi në besim mund të degjenerojë nga një vepër e Perëndisë në një vendim thjesht njerëzor. Por bashkësi të tilla – me një predikim të cekët, mendim laik dhe me një ungjill të përqendruar te vetja, i cili nxit jo më shumë se një rrëfim

të vetëm gojor të Krishtit (shpesh duke keqzbatuar Romakëve 10:9) – nuk mund të shpallë qartë lajmin e mrekullueshëm të shpëtimit në Krishtin.

Për të gjithë anëtarët e kishës, por sidomos për udhëheqësit që kanë privilegjin dhe përgjegjësinë e mësimdhënies, një kuptim biblik i ungjillëzimit është kyç. Natyrisht, mënyra se si dikush e ndan ungjillin lidhet ngushtë me mënyrën se si ai e kupton ungjillin. Nëse mendja juaj është formuar nga mësimet e Biblës për Perëndinë dhe ungjillin, për nevojën njerëzore dhe kthimin në besim, atëherë sigurisht një kuptim i drejtë i ungjillëzimit do të vijojë më pas. Ne duhet të jemi më të preokupuar për të njohur dhe për t'u mësuar të tjerëve ungjillin vetë, sesa thjesht të përpiqemi t'u mësojmë njerëzve metoda dhe strategji për ta ndarë atë.

Biblikisht, ungjillëzimi është paraqitja e lajmit të mirë lirshëm dhe duke besuar te Perëndia për kthimin në besim të njerëzve (shihni Veprat 16:14). “Shpëtimi vjen nga Zoti”, (Jona 2:9; krs. Gjoni 1:12-13). Çdo mënyrë me të cilën ne përpiqemi që të imponojmë lindjen shpirtërore do të jetë po kaq efikase sa edhe përpjekja e Ezekielit për të ngjitur eshtrat e thata me njëra-tjetrën, ose përpjekja e Nikodemit për të rilindur. Dhe rezultati do të jetë i njëjtë.

Nëse kthimi në besim kuptohet thjesht si një përkushtim i bërë vetëm një herë, atëherë duhet ta çojmë çdo njeri në atë pikë të rrëfimit dhe të përkushtimit verbal në çdo mënyrë që mundemi. Megjithatë, biblikisht, ndërkohë që ne duhet të kujdesemi, të bëjmë thirrje dhe t'i bindim njerëzit, detyra jonë e parë është që të jemi besnikë ndaj detyrës që kemi nga Perëndia, e cila është të paraqesim të njëjtin Lajm të Mirë që ai na ka dhënë. Perëndia do të bëjë kthime në besim nga paraqitja që i bëjmë këtij Lajmi të Mirë (shihni te Gjoni 1:13; Veprat 18:9-10).

Është inkurajuese se si të krishterët e rinj shpesh duken vetvetiu të vetëdijshëm për natyrën e hirshme të shpëtimit të tyre. Mbase ju keni dëgjuar dëshmi, edhe në javët apo muajt e fundit, të cilat ju kujtojnë juve se kthimi në besim është vepër e Perëndisë. “Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush” (Efesianëve 2:8-9).

Nëse anëtarësia e një kisha është shumë më e madhe sesa pjesëmarrja e saj, duhet ngritur pyetja: a ka ajo kishë një kuptim biblik të kthimit në besim? Për më tepër, ne duhet të bëjmë pyetjen se çfarë lloj ungjillëzimi është praktikuar dhe që ka rezultuar në një numër kaq të madh njerëzish që nuk janë të përfshirë në jetën e kishës, megjithatë e konsiderojnë anëtarësinë e tyre në status të mirë si një evidencë të shpëtimit të tyre? A ka kundërshtuar kisha në ndonjë mënyrë, apo ajo duket se e ka shfajësuar këtë situatë me anë të heshtjes? Disiplina biblike kishtarë është pjesë e ungjillëzimit të kishës.

Në ungjillëzimin tim personal, unë dëshiroj t'u përçoj tri gjëra njerëzve për vendimin që ata duhet të marrin në lidhje me ungjillin:

- Së pari, vendimi është i kushtueshëm (dhe prandaj duhet analizuar me kujdes, shihni te Lluca 9:62);
- Së dyti, vendimi është urgjent (dhe prandaj duhet të merret, shihni te Gjoni 3:18, 36);
- Së treti, vendimi ia vlen të merret (dhe prandaj duhet të merret, shihni te Gjoni 10:10).

Ky është ekuilibri për të cilin duhet të përpiqemi në ungjillëzimin tonë ndaj familjeve dhe miqve tanë. Ky është ekuilibri për të cilin duhet të përpiqemi në ungjillëzimin tonë si kishë e tërë.

Ka disa burime të shkëlqyera të botuara rreth ungjillëzimit. Për të parë lidhjen e ngushtë mes kuptimit tonë të ungjillit dhe metodave ungjillëzuese që përdorim, unë ju rekomandoj librin e Uill Metzgerit “*Thoni të vërtetën*” (*Tell the Truth*, Inter Varsity Press), dhe librat e Jan Mureit “*Sistemi i ftesës*” (*The Invitation System*) dhe “*Rizgjimi dhe Lëvizja e rizgjimit*” (*Revival and Revivalism*, Banner of Truth Trust).

Atëherë, një shenjë tjetër e një kisha të shëndetshme është një kuptim dhe praktikë biblike e ungjillëzimit. E vetmja rritje e vërtetë është rritja që vjen nga Perëndia.



## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Autori e përkufizon ungjillëzimin si “paraqitja e lajmit të mirë lirshëm dhe duke besuar te Perëndia për kthimin në besim të njerëzve”. Si ndikohet ungjillëzimi kur e kuptojmë se është Perëndia ai që bën punën e kthimit në besim? Çfarë mund të ndryshojë në ungjillëzimin tonë nëse ne e bindim veten se është përfundimisht e nevojshme për njeriun që të bëjë zgjedhjen për të kthyer veten në besim?

2. A është anëtarësia e kishës suaj shumë më e madhe sesa pjesëmarrja? Nëse po, cilat mendoni se janë arsyet për këtë? Në ungjillëzimin që bën kisha juaj, a paraqitet ungjilli në një mënyrë të ekuilibruar dhe të shëndetshme? Çfarë mund të bëhet për ta përmirësuar këtë ekuilibër?

3. Çfarë nënkupton autori kur thotë se vendimi për të ndjekur Krishtin është “i kushtueshëm”? Çfarë nënkupton ai kur thotë se vendimi është “urgjent”? Çfarë nënkupton ai kur thotë se vendimi “ia vlen të merret”? Cilat janë disa nga pasazhet biblike që mësojnë këto tri të vërteta?

# 6

## Një kuptim biblik i anëtarësisë së kishës

- I. ANËTARËSIA NË BIBËL
- II. ANËTARËSIA ËSHTË PËRKUSHTIM
- III. HENDEKU I MADH MES ANËTARËSISË DHE PËRFSHIRJES
- IV. ANËTARËSIA ËSHTË PËRGJEGJËSI
- V. ANËTARËSIA ËSHTË DËSHMIA E PËRBASHKËT PËR SHPËTIMIN
- VI. ANËTARËSIA KUPTIMPLOTE
- VII. PYETJE PËR REFLEKTIM

Në një kuptim, ajo që ne e njohim sot si “anëtarësi kishë” nuk është biblike. Ne nuk kemi asnjë dokumentim të të krishterëve të shekullit të parë që jetonin, ta zëmë, në Jerusalemin qendror, të cilët vendosën që të përfshiheshin në një asamble të veçantë të të krishterëve në vend të një tjetre. Nga ajo që mund të dallojmë, nuk kishte zgjedhje të kishës, sepse kishte vetëm një kishë në komunitet. Në këtë kuptim, ne nuk kemi dijeni për asnjë listë të anëtarëve të kishës në Dhiatën e Re. Por ka lista njerëzish të lidhura me kishën në Dhiatën e Re. Këto janë ose lista të vejtash që mbështeteshin ekonomikisht nga kisha (1Timoteut 5), ose të emrave në Librin e Jetës së Qengjit (Filipianëve 4:3; Zbulesa 21:27). Dhe ka pasazhe në Dhiatën e Re që lënë të kuptohet se kishte përkufizim dhe kufij të qartë për anëtarësinë në një kishë. Kishat i njihnin ata që përbënin anëtarësinë e tyre. Për shembull, letrat e Palit drejtuar kishës së Korintit tregojnë se disa individë duheshin përjashtuar (për shembull, 1Korintasve 5) dhe se disa duheshin përfshirë (për

shembull, 2Korintasve 2). Në këtë shembull të dytë, Pali përmend madje edhe një “shumicë” njerëzish (2Korintasve 2:6), që përmenden për faktin se kishin dhënë një “ndëshkim” të përjashtimit nga kisha. Kjo “shumicë” nuk mund të jetë tjetër veçse referencë për një shumicë njerëzish të cilët njiheshin si anëtarë të kishës.

Praktika e anëtarësisë kishtarë mes të krishterëve është krijuar si një përpjekje për të na ndihmuar që të mbajmë njëri-tjetrin në përgjegjësi dhe dashuri. Duke e identifikuar veten me një kishë të veçantë, ne u bëjmë të ditur pastorëve dhe anëtarëve të tjerë të asaj kishë lokale se ne synojmë që të jemi të përkushtuar në pjesëmarrje, dhurim, lutje dhe shërbesë. Ne i zmadhojmë pritjet e të tjerëve për ne në këto fusha dhe ne e bëjmë të ditur se ne jemi ata për të cilët kishë lokale ka përgjegjësi. Ne e sigurojmë kishën për përkushtimin tonë ndaj Krishtit për të shërbyer bashkë me ta dhe kërkojmë përkushtimin e tyre për të na shërbyer në dashuri dhe për të na inkurajuar në dishepullizimin tonë.

Në këtë kuptim, anëtarësia kishtarë është një ide biblike. Kjo gjë del mes të tjerash, edhe nga përdorimi i imazhit të trupit nga Pali për kishën lokale. Kjo gjë vjen nga shpëtimi që na jep Krishti me anë të hirit të Tij dhe vendosjes sonë në kisha për t'i shërbyer Atij në dashuri ndërsa u shërbejmë të tjerëve. Kjo vjen edhe nga detyrimet tona të ndërsjella të paraqitura në pasazhet e Shkrimit ku përdoren fjalët “së bashku” dhe “njëri-tjetrin”. Të gjitha këto përmblihen në besëlidhjen e një kishë të shëndetshme (shihni shtojcën).

Nuk duhet të na duket çudi që afrimi i kuptimit tonë për ungjillëzimin, kthimin në besim dhe ungjillin me atë të Biblës ndikon te mënyra se si e konceptojmë anëtarësinë kishtarë. Ne do të fillojmë ta shohim anëtarësinë gjithnjë e më pak si një lidhje të dobët të dobishme vetëm në disa raste dhe gjithnjë e më shumë si një përgjegjësi të rregullt, që na përfshin në jetën e njëri-tjetrit për qëllimet e ungjillit.

Nuk është e pazakontë që të gjesh një hendek të madh mes anëtarësisë kishtarë dhe numrit të atyre që janë të përfshirë aktivisht. Imagjinoni një kishë prej 3000 anëtarësh me vetëm 600 prej tyre që marrin pjesë rregullisht në takime. Kam frikë se shumë pastorë ungjillorë sot do të ishin më krenarë për anëtarësinë e deklaruar sesa të shqetësuar nga pjesëmarrja (e ulët). Sipas një studimi të fundit

të Konventës Baptiste Jugore, kjo është normale në kishat Baptiste Jugore. Një kishë tipike Baptiste Jugore ka 233 anëtarë dhe 70 veta në shërbesën e adhurimit të dielën në mëngjes. A është dhurimi ynë më i mirë? Cilat bashkësi kanë buxhete që arrijnë – le më të tejkalojnë – 10 përqind të të ardhurave totale vjetore të anëtarëve të tyre?

Përveçse në rastet kur kufizimet fizike e pengojnë pjesëmarrjen ose kur vështirësitë financiare e ndalojnë dhurimin, a nuk do të sugjeronte kjo situatë se anëtarësia është paraqitur si diçka që jo domosdo e kërkon përfshirjen? Megjithatë, çfarë nënkuptojnë numra të tillë të anëtarëve? Numrat e shkruar mund të jenë idhuj po aq lehtë sa edhe figurat e gdhendura – mbase edhe më lehtë. Por unë mendoj se është Perëndia Ai që do ta vlerësojë jetën tonë, Ai do ta peshojë punën tonë dhe nuk do të marrë parasysht numrat. Nëse kisha është një ndërtesë, atëherë ne duhet të jemi tulla në të; nëse kisha është një trup, atëherë ne jemi gjymtyrët e saj; nëse kisha është shtëpia e besimit, kjo presupozon se ne jemi pjesë e asaj shtëpie. Delet janë në një tufë dhe degët në një hardhi. Biblikisht, nëse dikush është i krishterë, ai duhet të jetë anëtar i një kisha. Duke lënë mënjanë detajet konkrete për një çast – qoftë nëse listat e anëtarësisë mbahen në kartonë të bardhë apo në disqe kompjuteri – ne nuk duhet të harrojmë të mblidhemi rregullisht (Hebrenjve 10:25). Kjo anëtarësi nuk është thjesht dokumentim i një deklaratë që e kemi bërë dikur, apo mall për një vend të njohur. Ajo duhet të jetë pasqyrim i një përkushtimi të gjallë, ose përndryshe është e pavlerë, dhe akoma më keq se kaq madje, mund të jetë edhe e rrezikshme.

Anëtarët e papërfshirë pështjellojnë jo vetëm anëtarët e vërtetë, por edhe jo të krishterët rreth asaj se çfarë do të thotë të jesh i krishterë. Dhe anëtarët “aktivë” nuk u vijnë në ndihmë për asnjë anëtarëve “joaktivë”, kur i lejojnë ata që të mbeten anëtarë të kishës; sepse anëtarësia është miratimi i përbashkët i kishës për shpëtimin e një personi. Edhe një herë, kjo duhet kuptuar qartë: anëtarësia në kishë është dëshmia e përbashkët e asaj kisha për shpëtimin e atij anëtari të veçantë. Megjithatë, si mundet bashkësia të dëshmojë në mënyrë të sigurtë se një njeri i padukshëm për të po vrapon me besnikëri në garë? Nëse anëtarët janë larguar nga grupi ynë dhe nuk kanë shkuar

te ndonjë kishë tjetër që beson te Bibla, çfarë dëshmie japim ne se ata kanë qenë ndonjëherë pjesë e jona? Ne nuk e dimë me domosdo se njerëz të tillë të papërfshirë nuk janë të krishterë; ne thjesht mund të mos jemi në gjendje që të deklarojmë se ata janë. Ne nuk duhet t'u themi atyre se e dimë që ata po shkojnë në Ferr, thjesht sepse nuk mund t'u themi se e dimë që ata po shkojnë në Parajsë.

Që një kishë të praktikojë anëtarësinë kishtarë biblike kërkohet jo përsosmëri, por sinqeritet. Nuk kërkohen vendime të thata, por dishepullizim i vërtetë. Ajo përbëhet jo vetëm nga eksperiencat individuale, por nga deklaratimet e përbashkëta të atyre që janë në besëlidhje me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin. Personalisht, unë shpresoj që të shoh që numrat e anëtarësisë në kishën ku unë shërbej të bëhen më kuptimplotë, ndërkohë që ata që janë anëtarë sa për emër të bëhen anëtarë të vërtetë. Për shumë veta, kjo ka nënkuptuar se atyre iu është hequr emri nga lista (por ata kanë mbetur në zemrat tona). Për të tjerët, kjo ka nënkuptuar një përkushtim të ripërtërirë ndaj jetës kishtarë. Anëtarët e rinj po mësohen në besim dhe në jetën e kishës. Shumë nga anëtarët aktualë kanë nevojë për mësim dhe inkurajim të ngjashëm. Ndërkohë që jemi përpjekur të bëhemi një kishë e shëndetshme baptiste siç kemi qenë historikisht, numri i njerëzve që marrin pjesë në takime e ka kaluar numrin e anëtarëve. Sigurisht, kjo duhet të jetë edhe dëshira juaj për kishën tuaj.

Praktika e rigjetur e anëtarësisë së kujdesshme kishtarë do të ketë shumë përfitime: Kjo gjë do ta bëjë dëshminë tonë para jo të krishterëve akoma më të qartë; do ta bëjë më të vështirë për delet më të dobëta që të largohen nga vatha, ndërkohë që e konsiderojnë veten akoma si dele; do të ndihmojë për t'i dhënë trajtë dhe fokus dishepullizimit të të krishterëve akoma më të pjekur; do t'i ndihmojë udhëheqësit e kishave tona që të dinë me saktësi se për kë person janë përgjegjës. Në gjithë këtë, Perëndia do të përlëvdohet.

Lutuni që anëtarësia kishtarë të mund të bëhet diçka më tepër sesa është aktualisht, në mënyrë që t'i njohim më mirë ata për të cilët jemi përgjegjës, në mënyrë që të mund të lutemi për ta, t'i inkurajojmë dhe t'i sfidojmë. Nuk duhet t'i lejojmë njerëzit që të vazhdojnë të jenë anëtarë të kishave tona për arsye sentimentale. E parë biblikisht, një

anëtarësi e tillë nuk është aspak anëtarësi. Në besëlidhjen e kishës sonë, ne japim fjalën gjithashtu se “Kur të shpërngulemi nga ky vend, do të bashkohemi ,sa më shpejt të jetë e mundur, me një kishë tjetër ku të mund të vazhdojmë në frymën e kësaj besëlidhjeje dhe të parimeve të Fjalës së Perëndisë”. Ky përkushtim është pjesë e dishepullizimit të shëndetshëm, sidomos në këtë kohë kur njerëzit shpërngulen shpesh.

Anëtarësia kishtare nënkupton të qenit të përfshirë në një mënyrë praktike në trupin e Krishtit. Kjo nënkupton udhëtimin e përbashkët si të huaj në këtë botë, ndërkohë që po shkojmë drejt shtëpisë sonë qiellore. Sigurisht, një shenjë tjetër e kishës së shëndetshme është kuptimi biblik i anëtarësisë kishtare.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. A përmend Bibla në mënyrë të drejtpërdrejtë lista anëtarësie në një kishë lokale? Ku është e nënkuptuar kjo gjë? Lexoni 1Korintasve 12:14-26. Si mund të na ndihmojë ne anëtarësia kishtare si të krishterë për të vënë në praktikë këto detyrime që kemi ndaj njëri-tjetrit si trupi i Krishtit?

2. Autori shkruan se ne duhet ta shikojmë anëtarësinë kishtare “gjithnjë e më pak si një lidhje të dobët, të dobishme vetëm në disa raste dhe gjithnjë e më shumë si një përgjegjësi që na përfshin neve në jetën e njëri-tjetrit për qëllimet e ungjillit”. Në dritën e kësaj deklaratë, si e shikojnë anëtarësinë shumica e anëtarëve tuaj? Cilat janë përgjegjësitë e një anëtari të kishës? Si mund të kontribuojë përmbushja e këtyre përgjegjësisve në punën e ungjillit?

3. Autori beson se anëtarësia kishtare duhet të jetë pasqyrimi i një përkushtimi të gjallë ndaj Krishtit, ose përndryshe ajo është pa vlerë dhe madje e rrezikshme. Pse mund të jetë e vërtetë kjo gjë? Përrshkruani përkushtimin e gjallë ndaj Krishtit dhe kishës së Tij.

4. Anëtarësia kishtare, shkruan autori, është dëshmia e përbashkët e kishës ndaj shpëtimit të një anëtari të veçantë. Lexoni Hebrejve 13:17. Bibla na mëson se udhëheqësve të kishës do t'u kërkohej “të japin llogari” për njerëzit që kanë nën kujdesin e tyre. A mendoni se kjo “llogari” do të jetë thjesht një deklaratë se një person ka marrë një herë një vendim për Krishtin, apo kjo është një dëshmi që vjen nga njohuria se një person po jep besnikërisht fryte në ungjill? Si ndikon kjo në të kuptuarit tonë se kush duhet të jetë në listat tona të anëtarësisë?

5. Autori rendit një sërë përfitimesh të shikimit me kujdes të listave të anëtarësisë së kishës sonë. Si do ta bënte më të qartë dëshminë tonë para jo të krishterëve një kuptim biblik i anëtarësisë kishtare? Si do ta bënte kjo më të vështirë për të krishterët e dobët që të largohen, ndërkohë që e konsiderojnë veten akoma si të krishterë? Si do të ndihmonte kjo që t'i jepte trajtë dhe fokus dishepullizimit të të krishterëve të pjekur?

# 7

## Disiplina kishtare biblike

- I. PERËNDIA KËRKON SHENJTËRI
- II. GJYKIMI
- III. PERËNDIA PRET QË KISHA TË GJYKOJË
- IV. MBYLLNI DERËN E PËRPARME, HAPNI DERËN E PASME
- V. SILLNI ANËTARË TË RINJ
- VI. USHTRIMI I DISIPLINËS ME PËRGJEGJËSI
- VII. PESË ARSYE PËR DISIPLINËN KORRIGJUESE
- VIII. PYETJE PËR REFLEKTIM

Shenja e shtatë e një kisha të shëndetshme është praktikimi i rregullt i disiplinës kishtare. Një praktikim biblik i disiplinës kishtare i jep kuptim të qenit anëtar i kishës. Megjithëse ajo është praktikuar gjerësisht nga kishat që nga koha e Krishtit, tashmë është zbehur shumë në jetën e rregullt të kishës ungjillore në brezat e fundit.

Ne njerëzit jemi krijuar fillimisht për të paraqitur imazhin e Perëndisë, për të qenë dëshmitarë të karakterit të Perëndisë para krijimit të Tij (Zanafilla 1:27). Prandaj nuk është çudi që në gjithë Dhiatën e Vjetër, ndërkohë që Perëndia përgatiti një popull për veten e Tij, ai iu dha atyre njerëzve udhëzime në shenjtëri, në mënyrë që karakteri i tyre të përafrohej me të Tijin (shihni te Levitiku 19:2; Fjalët e Urta 24:1, 25). Kjo ishte baza për korrigjimin dhe madje përjashtimin e disa vetave nga komuniteti në Dhiatën e Vjetër (si te Numrat 15:30-31), dhe kjo është bazae dhe për trajtën që i duhet dhënë kishës së Dhiatës së Re (shihni te 2Korintasve 6:14-7:1; 13:2; 1Timoteut 6:3-5; 2Timoteut 3:1-5).



Megjithatë, kjo ide u duket njerëzve sot shumë negative. Fundja, a nuk e ndaloi vetë Zoti Jezus gjykimin e të tjerëve te Mateu 7:1? Sigurisht, në njëfarë kuptimi Jezusi e ndaloi gjykimin te Mateu 7:1; por në po atë ungjill, Jezusi gjithashtu na thërret shumë qartë për t'i qortuar të tjerët për mëkatën, deri në masën e qortimit të tyre publikisht (Mateu 18:15-17; krs. Lluka 17:3). Prandaj, cilido të ketë qenë kuptimi i fjalëve të Jezusit kur ai e ndaloi gjykimin te Mateu 7:1, ai sigurisht nuk ka dashur të përjashtojë çdo gjë që nënkuptohet nga fjala “gjykim”.

Vetë Perëndia është gjykatës. Ai ishte në Kopshtin e Edenit dhe ne mbetemi nën gjykimin e Tij të drejtë për aq kohë sa mbetemi në mëkatet tona. Në Dhiatën e Vjetër, Perëndia i ka gjykuar si kombet ashtu edhe individët, dhe në Dhiatën e Re ne të krishterët paralajmërohemi se veprat tona do të gjykoen (shihni te 1Korintasve 3). Në dashuri, Perëndia i disiplinon fëmijët e Tij, dhe në zemërim, Ai do t'i dënojë të paperëndishmit (shihni te Hebrenjve 12). Natyrisht, në ditën e fundit, Perëndia do ta zbulojë Vetën si Gjykatës suprem (shihni te Zbulesa 20). Në gjithë këtë gjykim, Perëndia nuk gabon kurrë, dhe Ai është gjithnjë i drejtë (shihni te Jozueu 7; Mateu 23; Lluka 2: Veprat 5; Romakëve 9).

Shumë vetë sot habiten kur mësojnë se Perëndia kërkon që edhe të tjerët të gjykojnë. Shtetit i është dhënë përgjegjësia për të gjykuar (shihni te Romakëve 13). Neve na thuhet që të gjykojmë veten tonë (shihni te 1Korintasve 11:28; Hebrenjve 4; 2Pjetrit 1:5). Gjithashtu na thuhet që të gjykojmë njëri-tjetrin në kishë (megjithëse jo në mënyrën përfundimtare si gjykon Perëndia). Fjalët e Jezusit te Mateu 18, të Palit te 1Korintasve 5-6, dhe shumë pasazhe të tjera tregojnë qartë se kisha duhet të ushtrojë gjykim brenda vetvetes dhe se ky gjykim është për qëllime shpenguese, jo hakmarrëse (Romakëve 12:19). Në rastin e njeriut kurorëshkelës në Korint dhe të mësuesve të rremë në Efes, Pali thotë se ata duhen përjashtuar nga kisha dhe i duhen dorëzuar Satanit, në mënyrë që të mësojnë më mirë dhe kështu shpirtat e tyre të mund të shpëtohen (shihni te 1Korintasve 5; 1Timoteut 1).

Prandaj nuk është për t'u habitur që duhet të udhëzohemi për të gjykuar. Fundja, nëse nuk mund të themi se si nuk duhet të jetojë një i krishterë, si mund të themi se si duhet të jetojë? Një nga shqetësimet

e mia për shumë programe të dishepullizimit nëpër kisha është se ato ngjasojnë me hedhjen e ujit në kova të shpuara – gjithë vëmendja i kushtohet asaj që hidhet brenda, pa menduar për mënyrën se si merret dhe ruhet ajo.

Një autor që shkruan për rritjen e kishës e ka përmbledhur kështu këshillën e tij për ta ndihmuar kishën të rritet: “Hapni derën e përparme dhe mbyllni derën e pasme”. Me këtë, ai po thotë se duhet të punojmë që ta bëjmë kishën më të hapur për njerëzit dhe të bëjmë një punë më të mirë vijuese me ta. Të dy këto qëllime janë të mira. Megjithatë, shumica e pastorëve sot synojnë tashmë të kenë kisha me dyer të tilla të përparme të hapura dhe me dyer të pasme të mbyllura. Por, përpjekja për të ndjekur modelin biblik duhet të na çojë te kjo strategji: “Të mbyllim derën e përparme dhe të hapim derën e pasme”. Me fjalë të tjera, ta bëjmë më të vështirë për njerëzit të bashkohen me kishën nga njëra anë dhe më të lehtë për t’u përjashtuar nga ana tjetër. Veprime të tilla do ta ndihmojnë kishën që të rifitojë veçantinë e saj tërheqëse dhe të caktuar nga Perëndia, e cila e dallon nga bota.

Kjo disiplinë duhet të reflektohet së pari, në mënyrën se si ne si kisha i pranojmë anëtarët e rinj. A interesohemi më parë që ata që bëhen anëtarë të njihen se po jetojnë një jetë që e nderon Krishtin? A e kuptojmë seriozitetin e përkushtimit që ne po bëjmë ndaj tyre dhe të përkushtimit që ata po bëjnë ndaj nesh? Nëse jemi më të kujdesshëm rreth mënyrës se si i njohim dhe i pranojmë anëtarët e rinj, ne do të kemi më pak raste kur do të na duhet të praktikojmë disiplinën kishtare korrigjuese më vonë.

Natyrisht, çdo lloj discipline kishtare mund të ushtrohet në mënyrë të gabuar. Në Dhiatën e Re, neve na thuhet që të mos i gjykojmë të tjerët për motivet që u atribuojmë atyre (shihni te Mateu 7:1), ose të mos e gjykojmë njëri-tjetrin për çështje që nuk janë thelbësore (shihni te Romakëve 14-15). Kjo çështje është e mbushur me probleme në zbatimin pastoral, por ne duhet të kujtojmë se gjithë jeta e krishterë është e vështirë dhe e hapur ndaj abuzimit. Vështirësitë tona nuk duhen përdorur si një shfajësim për ta lënë ndonjërin prej tyre të papraktikuar. Çdo kishë lokale ka një përgjegjësi për ta gjykuar jetën dhe mësimin e udhëheqësve të saj, dhe madje edhe të anëtarëve të saj,

sidomos në rastin kur kjo gjë komprometon dëshminë e kishës për ungjillin (shihni te Veprat 17; 1Korintasve 5; 1Timoteut 3; Jakobi 3:1; 2Pjetrit 3; 2Gjonit).

Disiplina kishtare biblike është bindje e thjeshtë ndaj Perëndisë dhe një rrëfim i thjeshtë se ne kemi nevojë për ndihmë. Këtu kemi pesë arsye pozitive për një disiplinë të tillë kishtare korrigjuese. Qëllimi i saj është pozitiv (1) për individin e disiplinuar, (2) për të krishterët e tjerë kur ata shohin rrezikun e mëkatit, (3) për shëndetin e kishës në tërësi dhe (4) për dëshminë e përbashkët të kishës. Mbi të gjitha, (5) shenjtëria jonë duhet të reflektojë shenjtërinë e Perëndisë. Duhet të ketë një kuptim që të jesh anëtar i kishës, jo për hir të krenarisë sonë, por për hir të emrit të Perëndisë. Disiplina kishtare biblike është një shenjë tjetër e kishës së shëndetshme.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Lexoni te Gjoni 5:27-30. Kujt i ka dhënë Ati autoritet për të gjykuar? Tani lexoni te Mateu 18:15-17. Kujt i ka deleguar autoritet Jezusi për të gjykuar në këtë botë? A e ka administruar kisha besnikërisht këtë porosi që na ka dhënë Zoti?

2. Lexoni 1Korintasve 5:1-2. Çfarë veprimi, thotë Pali, duhet të kishte ndërmarrë kisha e Korintit në lidhje me anëtarin mëkatar? Tani lexoni vargjet 3-5. Me autoritetin e kujt (në emër të kujt) duhet të veprojë kisha? Cila është shpresa përfundimtare e një veprimi të tillë? A mendoni se Pali e konceptonte disiplinën e kishës si një veprim të pashpirt dhe mizor, apo si një veprim të kryer me dashuri që do t'i sillte përfitim shpirtit të personit?

3. Një autor ka thënë se të krishterët duhet “Të hapin derën e përparme të kishës dhe të mbyllin derën e pasme”. Çfarë kuptimi ka kjo deklaratë? Autori i këtij libri thotë se në vend të kësaj ne duhet “Të mbyllim derën e përparme dhe të hapim derën e pasme.” Cila prej tyre mendoni se është një ide më biblike? Sipas mendimit tuaj, cila ide do të çonte më shpejt drejt një anëtarësie kishtare të shëndetshme?

4. Lexoni Romakëve 14:1-4. Cilat janë disa nga mënyrat se si disiplina e kishës mund të jetë e hapur ndaj abuzimit? Kaloni pak kohë duke menduar rreth mënyrës se si kisha juaj mund të përmbushë besnikërisht dhe me kujdes porosinë e Zotit tonë dhënë te Mateu 18:15-17, ndërkohë që qëndron vigjilente ndaj abuzimeve.



# 8

## **Përkujdesja për nxitjen e dishepullizimit dhe rritjes së krishterë**

- I. RITJA E KRISHTERË
- II. SHENJTËRIA ËSHTË DËSHMI E RITJES
- III. NEGLIZHIMI I DISIPLINËS PENGON RITJEN
- IV. RITJA E PËRBASHKËT E BASHKËSISË
- V. RITJA (VETËM) NË DUKJE
- VI. PERËNDIA PËRLËVDOHET NË RITJË
- VII. PYETJE PËR REFLEKTIM

Një shenjë tjetër dalluese e kishës së shëndetshme është preokupimi i përgjithshëm për rritjen e kishës – jo thjesht për shtimin e numrit, por për rritjen e anëtarëve. Sot, disa mendojnë se dikush mund të jetë “i krishterë foshnjë” për gjithë jetën. Rritja shihet si një alternativë shtesë për dishepujt tepër të zellshëm. Por rritja është një shenjë e jetës. Pemët që rriten janë pemë të gjalla dhe kafshët që rriten janë kafshë të gjalla. Rritja përfshin shtim dhe përparim. Në shumë fusha të eksperiencës sonë, kur diçka ndalon së rrituri, ajo vdes.

Pali shpresonte që korintasit do të rriteshin në besimin e tyre të krishterë (2Korintasve 10:15). Ai shpresonte se efesianët do të “rriteshin në çdo gjë drejt Atij që është kreu, Krishti” (Efesianëve 4:15; krs. Kolosianëve 1:10; 2Thesalonikasve 1:3). Pjetri i këshillonte disa të krishterë të hershëm që “posi foshnja të sapolindura, të dëshironi fort qumështin e pastër të fjalës, që të rriteni me anë të tij” (1Pjetrit

2:2). Është tunduese për pastorët që t'i kthejnë kishat e tyre thjesht në statistika të menaxhueshme të pjesëmarrjes, të pagëzimeve, të dhurimeve dhe të anëtarësisë, në të cilat rritja është e prekshme; megjithatë, statistika të tilla nuk e përmbushin aspak rritjen e vërtetë të përshkruar nga Pali dhe të dëshiruar nga Perëndia.

Në librin e tij *“Traktat për ndjenjat fetare” (Treatise Concerning Religious Affections)*, Xhonatan Eduards sugjeron se rritja e vërtetë në dishepullizimin e krishterë nuk është, në fund të fundit, vetëm ngazëllim, përdorim më i shpeshtë i gjuhës fetare, apo njohje gjithnjë e më e madhe e Shkrimeve. Ajo nuk është, madje, as një rritje e dukshme në gëzim, dashuri apo përkujdesje për kishën. Edhe rritjet në zell apo në lavdërimin e Perëndisë dhe siguria në besimin që ka dikush nuk janë prova të pagabueshme të rritjes së vërtetë të krishterë. Çfarë është atëherë? Sipas Eduardsit, ndërkohë që të gjitha këto mund të jenë prova të rritjes së vërtetë të krishterë, shenja e vetme e sigurt dhe e vëzhgueshme është një jetë me shenjtëri gjithnjë e më të madhe, që i ka rrënjët në vetëmohimin e krishterë. Kisha duhet të karakterizohet nga një shqetësim jetik për këtë lloj perëndishmërie më të madhe në jetën e anëtarëve të saj.

Siç e pamë te shenja e shtatë, një nga pasojat e padëshiruara që vjen nga lënia pas dore e disiplinës së duhur nga kisha është vështirësia gjithnjë e më e madhe për të rritur dishepuj. Në një kishë të padisiplinuar, shembujt janë të paqartë dhe modelet të pështjelluara. Asnjë kopshtar nuk nis me qëllimin për të mbjellë barëra të këqija. Barërat e këqija janë në vetvete të padëshirueshme dhe ato mund të kenë efekt negativ mbi bimët përreth. Plani i Perëndisë për kishën lokale nuk na lejon që t'i lëmë barërat e këqija jashtë kontroll

Ndikimet e mira në bashkësinë e besëlidhjes së besimtarëve mund të jenë mjete në dorën e Perëndisë për të rritur njerëzit e Tij. Ndërkohë që njerëzit e Perëndisë ndërtohen dhe rriten së bashku në shenjtëri dhe dashuri sakrifikuese, ata duhet të përmirësojnë aftësinë e tyre për të administruar disiplinën dhe për të inkurajuar dishepullizimin. Kisha ka një detyrim për të qenë një mjet i Perëndisë për t'i rritur njerëzit në hir. Nëse në vend të kësaj ata janë vende ku vetëm mendimet e pastorit përvetësohen, ku Perëndia vihet në pikëpyetje më tepër sesa adhurohet, ku ungjilli dobësohet dhe ungjillëzimi shtrembërohet, ku

anëtarësia e kishës bëhet e pakuptimtë dhe një kult personaliteti sipas botës lejohet të rritet rreth pastorit, atëherë nuk mund të presim që të shohim një bashkësi të bashkuar apo që po ndërtohet. Një kishë e tillë sigurisht nuk do të përlëvdojë Perëndinë.

Perëndia përlëvdohet nga kisha që janë duke u rritur. Kjo rritje mund të shfaqet në mënyra të ndryshme: nga numri gjithnjë e më i madh i njerëzve që thirren në misione; nga mbajtja e një qëndrimi të ri përgjegjësie nga anëtarët më të vjetër në ungjillëzim; nga funeralet ku marrin pjesë shumë nga anëtarët më të rinj të bashkësisë, thjesht nga dashuria e tyre për anëtarët më të vjetër; nga shtimi i lutjeve dhe nga dëshira për më tepër predikim; nga takimet e kishës, të karakterizuara nga biseda vërtetë shpirtërore; nga shtimi i dhurimeve dhe nga njerëz që japin oferta gjithnjë e më sakrifkuese; nga një numër më i madh anëtarësh që e ndajnë ungjillin me të tjerët; nga prindërit që rizbulojnë përgjegjësinë që kanë për t'i edukuar fëmijët e tyre në besim. Këto janë vetëm disa shembuj të llojit të rritjes së kishës për të cilën lutem dhe punojnë të krishterët.

Kur shohim një kishë që është e përbërë nga anëtarë që rriten në ngjashmërinë me Krishtin, kush e merr meritën ose lavdinë? “Perëndia i bëri të rriten. Kështu, pra, as ai që mbjell, as ai që ujit, nuk është gjë, por Perëndia që rrit” (1Korintasve 3:6b-7; krs. Kolosianëve 2:19). Kështu, bekimi i fundit i Pjetrit për ata të krishterë të hershëm, të cilëve u shkroi, ishte një lutje e shprehur në mënyrën urdhërore: “Rrituni, në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht. Atij i qoftë lavdia, tani dhe përjetë! Amen” (2Pjetrit 3:18). Ne mund të mendojmë se rritja jonë do të na sjellë neve lavdi. Por Pjetri e di se kjo është gabim. “Silluni mirë ndër johebrenjtë, që aty ku do t’ju paditin si keqbërës, të përlëvdojnë Perëndinë ditën e ardhjes së Tij, për shkak të veprave tuaja të mira” (1Pjetrit 2:12). Duket qartë se ai kujton fjalët e Jezusit: “Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira” – dhe sigurisht këtu mund të mendonim se do të ishte e natyrshme që të binim në grackën e vetadmirimit, por Jezusi vazhdon më tej – “dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qije” (Mateu 5:16). Të punuarit për të nxitur dishepullizimin dhe rritjen e krishterë është një shenjë tjetër e kishës së shëndetshme.



## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Lexoni 1Pjetrit 2:1-3. Cila është shpresa e Pjetrit për këta të krishterë? Çfarë nënkupton ai me “rritje” në shpëtim?

2. Disa njerëz mendojnë se “rritje e kishës” do të thotë vetëm rritje e numrit. Lexoni Veprat 2:41. Sipas mendimit tuaj, pse është dokumentuar numri i të kthyerve në besim? Tani lexoni pjesën e mbetur të kapitullit 2. A do të kishte qenë përlëvdues për Perëndinë numri i madh i të kthyerve në besim nëse ata nuk do të ishin duke u rritur edhe në shenjtëri? Pse po, ose pse jo?

3. Autori shkruan se barërat e këqija mund të kenë një efekt negativ te bimët përreth. Në çfarë mënyrash mund të ndikojnë negativisht te të krishterët përreth, anëtarët mëkatarë dhe të padisiplinuar të kishës? Si mund të jenë mjete në dorën e Perëndisë për rritjen e njerëzve të Tij ata që kanë ndikim të mirë në kishë? A mund të sillni ndër mend disa shembuj në kishën tuaj?

4. Cilat janë disa nga mënyrat se si përlëvdohet Perëndia nga një kishë që rritet në pjekurinë shpirtërore? Sa nga këto gjëra i shihni vazhdimisht në jetën e kishës suaj?

# 9

## Udhëheqja biblike e kishës

- I. POSTI BIBLIK I PLAKUT TË KISHËS
- II. HISTORI E SHKURTËR E PLEQVE TË KISHËS
- III. BASHKËSIA ËSHTË AUTORITETI PËRFUNDIMTAR
- IV. TË GJITHË PLEQTË E KISHËS JANË “MËSUES”
- V. SHUMËSIA E PLEQVE TË KISHËS
- VI. ROLI I VEÇANTË I PASTORIT
- VII. DOBITË E SHUMËSISË SË PLEQVE TË KISHËS
- VIII. NGATËRRIMI I PLEQVE TË KISHËS ME DHJAKËT
- IX. PYETJE PËR REFLEKTIM

Çfarë lloj udhëheqjeje ka një kishë e shëndetshme? Një bashkësi, të përkushtuar ndaj Krishtit dhe me dhunti për të shërbyer? Po. Dhjakë që janë model i shërbesës në çështjet e kishës? Po. Një pastor që është besnik në predikimin e fjalës së Perëndisë? Po. Por, biblikisht, ka edhe diçka tjetër që është pjesë e udhëheqjes së një kishë të shëndetshme: pleqtë e kishës.

Si pastor, unë lutem që Krishti do të vendosë brenda bashkësisë sonë njerëz, dhuntitë shpirtërore dhe përkujdesjet pastorale të të cilëve tregojnë se Perëndia i ka thirrur ata për të qenë pleq kishë ose mbikëqyrës (fjalët përdoren në mënyrë të këmbyeshme në Bibël; p.sh., Veprat 20). Unë lutem që Perëndia do t'i rrisë dhe t'u japë dhunti dishepujve të tillë për punën e mbikëqyrjes pastorale të bashkësisë sonë dhe të mësimave të saj. Nëse bëhet e qartë se Perëndia i ka dhënë dhunti të tilla një njeriu të caktuar në kishë, dhe nëse, pas lutjes, kisha i njeh dhuntitë e tij, atëherë ai duhet caktuar si plak kishë.

Të gjitha kishat kanë pasur individë që kanë kryer funksionet e pleqve të kishës, edhe nëse i kanë quajtur ata me një emër tjetër. Dy emrat e Dhiatës së Re për këtë post ishin *episkopos* (mbikëqyrës) dhe *presbuteros* (plak kishë). Kur ungjillorët dëgjojnë fjalën “plak kishë”, shumë mendojnë menjëherë se flitet për “Presbiterianët”, megjithatë Kongregacionalistët e parë (kongregacion = bashkësi), në shekullin e gjashtëmbëdhjetë mësonin se posti i pleqve të kishës ka ekzistuar që në kishën e Dhiatës së Re. Pleqtë e kishës gjendeshin në kishat Baptiste të Amerikës gjatë gjithë shekullit të 18<sup>te</sup> dhe të shekullit të 19<sup>te</sup>. Në fakt, presidenti i parë i Konventës Baptiste Jugore, V. B. Xhonsion, ka shkruar një traktat, në të cilin ai bën thirrje që praktika e pasjes së një shumësie pleqsh kishë të njihet si biblike dhe të ndiqet në më tepër kisha baptiste. Thirrja e Xhonsionit kaloi pa u dëgjuar. Qoftë nga mosvëmendja ndaj Shkrimeve apo nga presionet e jetës në front, ku kishat po shtoheshin në një masë të madhe, praktika e kultivimit të një udhëheqjeje të tillë të ndërthurur filloi të binte. Por botimet e gazetave baptiste mbi ringjalljen e kësaj mënyre biblike drejtimi vazhduan. Në vitet e para të shekullit të njëzetë, botimet baptiste u referoheshin drejtuesve me titullin e “plakut” .

Baptistët dhe presbiterianët kanë pasur dy ndryshime bazë në të kuptuarit e pleqve të kishës. E para dhe kryesorja, baptistët janë kongregacionalistë. Pra, ata e kuptojnë se dallimi përfundimtar për çështjet e ndryshme nuk u mbetet pleqve të kishës në një bashkësi (ose më tej, si në modelin presbiterian), por bashkësisë në tërësi. Prandaj, baptistët theksojnë natyrën konsensuale të veprimit kishitar. Pra, në një kishë baptiste, pleqtë dhe gjithë këshillat dhe komitetet e tjera veprojnë në atë që është përfundimisht një kapacitet këshillues për gjithë bashkësinë.

Një koment tjetër duhet bërë për autoritetin e bashkësisë së mbledhur. Asgjë tjetër përveç bashkësisë lokale, të mbledhur, nuk është gjykata përfundimtare e apelit nën Krishtin. Në mënyrë të përsëritur në Dhiatën e Re gjejmë dëshmi për atë që duket se është një formë e hershme e kongregacionalizmit. Te Mateu 18, kur Jezusi po mësonte dishepujt e Tij se si të veprojnë me vëllanë mëkatar, gjykata përfundimtare nuk janë pleqtë, as ndonjë peshkop apo papë, as ndonjë

këshill apo kuvend. Gjykata përfundimtare është bashkësia. Te Veprat 6, apostujt ia lanë në dorë vendimin për dhjakët bashkësisë.

Edhe në letrat e Palit gjejmë dëshmi për këtë marrje të përgjegjësive përfundimtare të bashkësisë. Te 1Korintasve 5, Pali nuk qorton pastorin, as pleqtë e kishës apo dhjakët, por bashkësinë për tolerimin e mëkatit. Te 2Korintasve 2, Pali iu referua asaj që shumica e tyre kishin bërë në disiplinimin e një anëtarit që kishte gabuar. Te Galatasve, Pali u bën thirrje bashkësive që të gjykojnë mësimin që kishin qenë duke dëgjuar. Te 2Timoteut 4, Pali qorton jo vetëm mësuesit e rremë, por edhe ata që i paguanin këta mësues të rremë për t'u mësuar ato gjëra që veshët e tyre dëshironin t'i dëgjonin. Pleqtë e kishës udhëheqin, por ata e bëjnë këtë gjë biblikisht dhe domosdoshmërisht brenda caqeve të njohura nga bashkësia.

Mosmarrëveshja e dytë ka të bëjë me rolin dhe përgjegjësinë e pleqve të kishës. Presbiterianët priren të theksojnë deklaratën e Palit drejtuar Timoteut te 1Timoteut 5:17: “Pleqtë që e drejtojnë mirë parësinë në kishë, le të nderohen dyfish, sidomos ata që mundohen me fjalë e me mësim”. Fraza e fundit, kanë argumentuar disa, sugjeron qartë se do të kishte pleq kishë, puna kryesore e të cilëve nuk ishte predikimi apo mësimi, por qeverisja dhe drejtimi. Kjo është origjina e dallimit mes “pleqve qeverisës” (pleqve të thjeshtë) dhe “pleqve mësues” (shërbyes) te Presbiterianët.

Por fjala “sidomos” është një përkthim i dyshimtë i fjalës *malista*, që në këtë kontekst përkthehet më mirë si “sigurisht” ose “veçanërisht”. Më sipër, te 1Timoteut 4:10 lexojmë: “Kemi shpresuar në Perëndinë e gjallë, që është Shpëtimtari i gjithë njerëzve dhe sidomos (*malista*) i besimtarëve”. Pali thotë se, po aq njerëz që do të shpëtohen pa besuar, aq njerëz do të drejtojnë çështjet e kishës pa predikuar dhe dhënë mësim: me fjalë të tjera, asnjë.

Baptistët kanë pasur tendencën për të theksuar këmblyeshmërinë e termave “plak kishë”, “mbikëqyrës” dhe “pastor” në Dhiatën e Re, dhe kanë vënë në dukje se te 1Timoteut 3:2, Pali qartësisht po i thotë atij se pleqtë duhet të jenë “të zotë të mësojnë të tjerët”. Dhe ai i shkruan Titit se një plak kishë duhet të “mbajë fort fjalën besnike siç i është mësuar, që të jetë në gjendje me doktrinën e shëndoshë të këshillojë

dhe të bindë ata që kundërshtojnë” (Titit 1:9). Prandaj baptistët shpesh e kanë mohuar përshtatshmërinë e të pasurit pleq kishe që nuk janë të zotë t’u mësojnë Shkrimet të tjerëve.

Megjithatë, gjëja për të cilën baptistët dhe presbiterianët e shekullit të tetëmbëdhjetë binin shpesh dakord ishte se duhet të kishte një shumësi pleqsh në çdo kishë lokale. Megjithëse nuk sugjerohet asnjëherë një numër specifik i pleqve për një bashkësi të veçantë, Dhiata e Re qartësisht u referohet “pleqve të kishës” në shumës në kishat lokale (p.sh., Veprat 14:23; 16:4; 20:17; 21:18; Titit 1:5; Jakobi 5:14). Eksperienca ime më konfirmon dobishmërinë e ndjekjes së praktikës së Dhiatës së Re për të pasur, atje ku është e mundur, më tepër pleq kishe në një kishë lokale, sesa thjesht një pastor të vetmuar, dhe ata të jenë njerëz që i kanë rrënjët në bashkësi. Kjo praktikë është e pazakontë mes kishave baptiste sot, por ekziston një tendencë në rritje në këtë drejtim – dhe kjo për një arsye të mirë. Kjo ishte e nevojshme në kishat e Dhiatës së Re dhe është e nevojshme edhe sot.

Kjo nuk do të thotë se pastori nuk ka asnjë rol të veçantë. Ka shumë referenca në Dhiatën e Re për predikimin dhe predikuesit, që nuk mund të gjejnë zbatim për të gjithë pleqtë e kishës në bashkësi. Kështu në Korint, Pali iu kushtua ekskluzivisht predikimit në një mënyrë që pleqtë e thjeshtë të një kishe nuk mundën (Veprat 18:5; krs. me 1Korintasve 9:14; 1Timoteut 4:13; 5:17). Predikuesit duket se zhvendoseshin në një zonë të caktuar qëllimisht për të predikuar (Romakëve 10:14-15), ndërsa pleqtë e kishës duket se ishin tashmë pjesë e bashkësisë (Titit 1:5). (Për më tepër për këtë dallim shihni te libri “*Një shfaqje e lavdisë së Perëndisë*” (*A Display of God’s Glory* [CCR: 2001]).

Megjithatë, duhet të kujtojmë se predikuesi, ose pastori, është gjithashtu një nga pleqtë e bashkësisë së tij. Kjo do të thotë se vendimet që kanë lidhje me kishën, por që nuk kërkojnë vëmendjen e të gjithë anëtarëve, duhet t’i lihen jo vetëm pastorit, por edhe pleqve së bashku. Ndonëse kjo nganjëherë është e komplikuar, ajo sjell shumë dobi, sepse plotëson dhuntitë e pastorit, duke mbuluar disa nga defektet e tij, duke plotësuar gjykimin e tij dhe duke krijuar mbështetje në bashkësi për vendimet, dhe udhëheqësit janë më pak të ekspozuar

ndaj kritikave të padrejta. Kjo, gjithashtu, e bën udhëheqjen më të rrënjësor, më të qëndrueshme dhe lejon që të ketë një vazhdimësi më të pjekur. Kjo e inkurajon kishën që të marrë më tepër përgjegjësi për jetën e saj shpirtërore dhe e ndihmon kishën, që të jetë më pak e varur nga punonjësit e vet.

Shumë kisha moderne kanë pasur prirjen për t'i ngatërruar pleqtë e kishës me personelin e kishës ose me dhjakët. Dhjakët, gjithashtu, zënë një post që është nga Dhiata e Re dhe që bazohet te Veprat 6. Ndërkohë që çdo dallim absolut mes dy posteve është i vështirë, detyrat e dhjakëve janë detajet praktike të jetës së kishës: administrimi, mirëmbajtja dhe kujdesi për anëtarët e kishës që kanë nevoja fizike. Në shumë kisha sot, dhjakët kanë marrë njëfarë roli shpirtëror; por një ngarkesë e madhe thjesht i është lënë pastorit. Do të ishte në dobi të kishës që të bënte përsëri dallimin e rolit të plakut të kishës nga ai i dhjakut.

Pleqësia e kishës është posti biblik që unë mbaj si pastor: unë jam plaku kryesor predikues. Por të gjithë pleqtë duhet të punojnë së bashku për ndërtimin e kishës, duke u takuar rregullisht për t'u lutur dhe për të diskutuar, ose për të bërë rekomandime për dhjakët ose për kishën. Sigurisht, kjo është një ide biblike që ka vlerë praktike. Nëse zbatohet në kishat tona, ajo mund t'i ndihmojë shumë pastorët, duke hequr ngarkesën nga supet e tyre dhe madje edhe tiranitë e tyre të vogla nga kisha. Në fakt, praktika e njohjes së besimtarëve të thjeshtë të perëndishëm, të mprehtë e të besuar si pleq kisha është një shenjë tjetër e një kisha të shëndetshme.

## PYETJE PËR REFLEKTIM

1. Lexoni Mateun 18:15-17. Kë njuh Jezusi si gjykatë përfundimtare të apelit në gjykimin e një vëllai fajtor? Tani lexoni Veprat 6:1-4. Kë ngarkojnë apostujt për të zgjedhur shtatë dhjakët? Lexoni gjithashtu 2Korintasve 2:6. Nga kush u dha ndëshkimi për këtë njeri? Çfarë duket se thonë këto pasazhe rreth faktit se kush është autoriteti përfundimtar në çështjet e kishës?

2. Lexoni Titin 1:5. Duke e kuptuar se autoriteti përfundimtar në kishë i mbetet bashkësisë së mbledhur, sipas mendimit tuaj, pse Pali mendon gjithsesi se është urtësi që të kemi pleq kishë në çdo kishë?

3. Te 1Timoteut 3:1-6, Pali jep një listë të cilësive për një plak. Kaloni ca kohë duke menduar rreth arsyes pse këto tipare të karakterit janë kaq të rëndësishme për udhëheqësin e një kishë. Kush i përmbush këto cilësi në kishën tuaj?

4. Lexoni Veprat 6:1-4. Cili është ndryshimi mes rolit të dhjakut dhe rolit të dikujt që mbikëqyr çështjet e kishës? A e pranon kisha juaj atë dallim në qeverisjen e saj?

5. Nga Veprat 6 ne mësojmë se detyra e dhjakëve ishte që të kujdeseshin për nevojat fizike të kishës, duke i liruar kështu mbikëqyrësit e kishës (apostujt, pleqtë e kishës dhe pastorët) për t'iu kushtuar lutjes dhe shërbesës së fjalës. Cilat janë disa nga nevojat e vazhdueshme fizike të kishës suaj, që mund të përmbushen nga një dhjak? Çfarë rolesh të tjera mund të luajnë dhjakët në ruajtjen e unitetit të kishës apo në mbështetjen e pastorëve të Fjalës në kishën tuaj?

## **Përfundim**

Kur të mund të presupozojmë me të drejtë se pjesëtarët e kishës janë të rilindur dhe se ata që janë të rilindur janë të përkushtuar ndaj kishës, atëherë shëmbëlltyrat e Dhiatës së Re për kishën mund të ilustrohen në mënyrë të gjallë në bashkësitë tona. Në mirësinë e Tij, Perëndia na ka thirrur që të jetojmë jetën e krishterë së bashku, ndërkohë që dashuria dhe kujdesi ynë i ndërsjellë reflekton dashurinë dhe kujdesin e Perëndisë. Marrëdhëniet nënkuptojnë përkushtim në botë: sigurisht, edhe në kishë ato nënkuptojnë jo më pak përkushtim.

Në urdhërimin e tretë (Eksodi 20:7; Ligji i Përtërirë 5:11), Perëndia i paralajmëron njerëzit e Tij që të mos e përdorin kot emrin e Tij. Kjo nuk është thjesht një ndalesë e gjuhës së paudhë, por ky urdhërim na ndalon që ta përdorim emrin e Perëndisë më kot, në mënyrë të pakuptimtë, pa qëllim ose me një qëllim të keq.

Ky urdhërim është për ne në kishë. Shumë kisha sot janë të sëmurura. Ne e ngatërrojmë përfitimin personal me rritjen shpirtërore. Ne e ngatërrojmë ngazëllimin me adhurimin e vërtetë. Ne çmojmë pranimin e botës, në vend që të jetojmë në mënyrë të tillë që të ngjallim kundërshtimin e botës. Pavarësisht nga profilet e tyre statistikore, shumë kisha sot duket sikur nuk shqetësohen për shenjatbiblike që duhet të dallojnë një kishë të gjallë që rritet.

Shëndeti i kishës duhet të jetë shqetësimi i të gjithë të krishterëve, sidomos i atyre që janë thirrur për të qenë udhëheqës në kishë. Kishat tona duhet të shfaqin Perëndinë dhe Ungjillin e Tij të lavdishëm për krijesën e Tij. Ne duhet t'i sjellim Atij lavdi, me anë të jetës sonë së bashku. Kjo barrë e prezantimit është përgjegjësia jonë dhe është privilegji ynë i madh.



*Nëntë Sbenjat të një Kisbe të Shëndetsbme*

SHTOJCË

## **Një besëlidhje tipike e një kishe të shëndetshme**

Pasi jemi sjellë, siç besojmë, nga Hiri Hyjnor në pendim dhe në besim të Zoti Jezu Krisht dhe për t'ia dorëzuar veten tonë Atij, dhe pasi jemi pagëzuar pas deklaramit tonë të besimit, në emër të Atit dhe të Birit dhe të Frymës së Shenjtë, duke u mbështetur te ndihma e Tij e hirshme, ne përtërijmë tani me solemnitet dhe gëzim besëlidhjen tonë me njëri-tjetrin.

Ne do të punojmë dhe do të lutemi për unitetin e Frymës në marrëveshjen e paqes.

Ne do të ecim së bashku në dashuri vëllazërore, siç u ka hije anëtarëve të një kishe të krishterë; do të ushtrojmë kujdes dhe vigjilencë ndaj njëri-tjetrit dhe me besnikëri do të qortojmë dhe do të nxisim njëri-tjetrin siç mund ta kërkojë rasti.

Ne nuk do të heqim dorë nga të mbledhurit bashkë dhe as nuk do të lëmë pas dore të luturit për veten dhe për të tjerët.

Ne do të përpiqemi që të edukojmë ata që në çfarëdo kohe janë nën kujdesin tonë, sipas ushqimit dhe këshillës së Zotit, dhe me një shembull të pastër dhe të dashur të kërkojmë shpëtimin e familjes dhe të miqve tanë.

Ne do të gëzohemi nga lumturia e njëri-tjetrit dhe do të përpiqemi me zemërbutësi dhe dhembshuri të mbajmë barrët dhe vuajtjet e njëri-tjetrit.

Ne do të përpiqemi me anë të ndihmës Hyjnore, të jetojmë me kujdes në botë, duke mohuar paperëndishmërinë dhe dëshirat e botës dhe duke mos harruar se, ashtu siç jemi varrosur vullnetarisht me anë të pagëzimit dhe jemi ringjallur përsëri nga varri simbolik, ashtu tani kemi një detyrim të veçantë për të jetuar një jetë të re dhe të shenjtë.

Ne do të punojmë së bashku për vazhdimësinë e shërbesës besnike ungjillore në këtë kishë, duke ruajtur adhurimin, rregullat, disiplinën dhe doktrinat e saj. Ne do të kontribuojmë me gëzim dhe rregullisht për mbështetjen e shërbesës, për shpenzimet e kishës, për të ndihmuar të varfrit dhe për përhapjen e Ungjillit në të gjitha kombet.

Sapo të ndërrojmë vendbanim, do të bashkohemi me ndonjë kishë tjetër ku mund të vazhdojmë frymën e kësaj besëlidhjeje dhe parimet e Fjalës së Perëndisë.

Hiri i Zotit Jezu Krisht, dhe dashuria e Perëndisë, dhe bashkësia e Frymës së Shenjtë qoftë me ne të gjithë! Amen.



*Nëntë Sbenjat të një Kisbe të Shëndetsbme*











**N**ë ditët e sotme, shumë libra që janë në qarkullim dhe shumë folës po pohojnë që pothuajse çdo atribut i mundshëm, stil adhurimi, program kompjuteri, libër, qendër zëri, seminar, shërbesë, program edukimi, grup, filozofi, metodë, doktrinë, virtyt, përvojë shpirtërore, projekt vendesh parkimi, apo strukturë menaxhimi e përfytyrueshme, është çelësi drejt një kishë të suksesshme. Kush ka të drejtë? Si mund ta dish nëse një kishë është e shëndetshme? Çfarë mund të bësh për të inkurajuar rritjen biblike të vazhdueshme, e cila lavdëron Perëndinë?

“Rrënjët e Reformacionit të vërtetë fillojnë me rizgjimën e kishës lokale. Mark Dever lëshon një thirrje të fuqishme dhe plot pasion për bashkësitë që t’i marrin seriozisht përgjegjësitë e besëlidhjes së tyre, jo për madhëstinë e vetes, por për lavdinë e Perëndisë dhe për shpëtimin e shpirtave të humbur për perjetësi. “Nëntë Shenjat e Kishës së Shëndetshme” është shumë i nevojshëm si “trakt për kohërat”. U lexoftë dhe u rilexoftë nga pastorët, drejtuesit e kishës dhe nga gjithë populli i Perëndisë, që mezi presin të shohin një rizgjim prej Tij në këtë brez”.

*Timothy George,  
Dekan, Shkolla Beeson Divinity, Universiteti Samford*

“Nëse krishterimi ungjillor do të rifitojë dhe pastaj do ta ruajë “kripshmërinë” në botë, atëherë duhet të ndodhë një reformacion i vërtetë në kishën lokale. Mark Dever e kupton këtë dhe libri “Nëntë Shenjat” është një recetë biblike për këtë reformacion. Perëndia e përdortë në këtë mënyrë”!

*J. Ligon Duncan III, Ph.D.  
Predikues, Kisha e Parë Presbiteriane, Jackson, Mississippi  
Asistent Profesor, Seminari i Reformuar Teologjik*

Mark E. Dever është pastori i Kishës Baptiste në Kapitol Hill, në Uashington, D. C. Ai ndoqi universitetin Duke, mori gradën M.Div nga Seminari Teologjik Gordon-Konuell, gradën Th.M nga Seminari Teologjik Baptist i Jugut dhe gradën PH.D. nga Universiteti i Kembrixhit. Marku është drejtuesi më i lartë i Qendrës për Reformimin e Kishës. Jeton në Uashington me të shoqen, Connie, dhe dy fëmijët, Annie dhe Natha.



9 781727 846096

**Vernon Publishing**